Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Zbatuar nga:

Save the Children

SHKOLLAT PËR SHËNDETIN

PLANI I PËRMIRËSIMIT TË VEPRIMTARIVE VJETORE QË KONTRIBUOJNË NË SHËNDETIN E NXËNËSVE

Dimal

Përmbajtje

AKRONIME **4**

1. Hyrje **5**

2. Veprimet për Planin e Përmirësimit **7**

2.1 Kapaciteti i shkollës në drejtim të vlerësimit të situatës dhe nevojave shëndetësore dhe mirëqenies. **8**

2.1.1 Qëllimi kryesor 8

2.1.2 Nën-Objektiva 8

2.1.3 Indikatorët e Performancës 9

2.1.4 Lista e veprimeve 10

2.1.5 Lista e projekteve 11

2.2 Shëndeti dhe mirëqenia si pjesë e planeve të shkollës **19**

2.2.1 Qëllimi kryesor 19

2.2.2 Nën-Objektiva 19

2.2.3 Indikatorët e Performancës 19

2.2.4 Lista e veprimeve 20

2.2.5 Lista e projekteve 21

2.3 Mjedisi fizik në shkollë **24**

2.3.1 Qëllimi kryesor 24

2.3.2 Nën-Objektiva 24

2.3.3 Indikatorët e Performancës 25

2.3.4 Lista e veprimeve 25

2.3.5 Lista e projekteve 26

2.4 Mjedisi social në shkollë **29**

2.4.1 Qëllimi kryesor 29

2.4.2 Nën-Objektiva 29

2.4.3 Indikatorët e Performancës 29

2.4.4 Lista e veprimeve 30

2.4.5 Lista e projekteve 31

2.5 Nxitja e aftësive për përmirësimin e shëndetit **32**

2.5.1 Qëllimi kryesor 32

2.5.2 Nën-Objektiva 32

2.5.3 Indikatorët e Performancës 32
2.5.4 Lista e veprimeve 33
2.5.5 Lista e projekteve 34
2.6 Lidhja e shkollës me komunitetin e prindërve dhe më gjerë 36
2.6.1 Qëllimi kryesor 36
2.6.2 Nën-Objektiva 36
2.6.4 Lista e veprimeve 37
2.6.5 Lista e projekteve 38
2.7 Stafi i shkollës 42
2.7.1 Qëllimi kryesor 42
2.7.2 Nën-Objektiva 42
2.7.3 Indikatorët e Performancës 43
2.7.4 Lista e veprimeve 43
2.7.5 Lista e projekteve 44
2.8 Menaxhimi i procesit të promocionit të shëndetit dhe mirëqenies nga shkolla 49
2.8.1 Qëllimi kryesor 49
2.8.2 Nën-Objektiva 49
2.8.3 Indikatorët e Performancës 49
2.8.4 Lista e veprimeve 50
2.8.5 Lista e projekteve 51
Aneks A- Kalendari i aktiviteteve 52

AKRONIME

ZVAP- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

NJVQV- Njësia e Vetëqeverisjes Vendore

CU- Cikël i Ulët

AF- Arsim Fillor

AMU- Arsim i Mesëm i Ulët

DN- Dispozitë Normative

AK- Aftësi e Kufizuar

PEI- Plan Edukativ Individual

OJF- Organizata Jo Fitimprurëse

OBSH- Organizata Botërore e Shëndetësisë

IA- Institucion Arsimor

SHI- Indeksi Shëndetësor i Shkollës

BAS- Instrumenti “Vlerësimi Bazë i Shkollës”

HBCS- Karakteristikat e Sjelljeve Shëndetësore tek Nxënësit e Shkollave

1. Hyrje

Projekti “Shkollat për Shëndetin”, do të mbështesi teknikisht hartimin e “Planeve të Përmirësimit të Veprimtarive Vjetore që Kontribuojnë në Shëndetin e Nxënësve”, për vitin akademik 2025-2026, i kontekstualizuar në bazë të problematikave që ka ZVAP Dimal, duke identifikuar mangësitë dhe nevojat për përmirësimin e shkollave në aspektin shëndetësor.

Në Planin e Përmirësimit të Veprimtarive për ZVAP Dimal është bërë vlerësimi i detajuar i shkollave në lidhje me aspekte të sjelljeve shëndetësore, duke u bazuar në tre studime të realizuara nga projekti “Shkollat për Shëndetin”: “Indeksi Shëndetësor i Shkollës (SHI)”, “Karakteristikat e Sjelljeve Shëndetësore tek Nxënësit e Shkollave (HBCS)”, dhe “Kompetencat Shëndetësore tek Nxënësit” (Health Literacy, HL), si dhe statistikat zyrtare vjetore që raportojnë vetë shkollat.

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e arsimit bazë në aspektin shëndetësor. Plani i përmirësimit synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese që lidhen me shëndetin në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjike.

Qëllimi i planit vjetor për përmirësimin e promocionit shëndetësor në shkolla është të ndikojë në shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve nëpërmjet ofrimit të një mjedisi të shëndetshëm dhe mbështetjes në nxitjen e sjelljeve dhe aktiviteteve të shëndetshme.

Kjo mund të arrihet përmes ngritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit të nxënësve për rëndësinë e një diete të shëndetshme, aktivitetit fizik dhe higjenës personale, si dhe përmes organizimit të aktiviteteve dhe evenimenteve shëndetësore në shkollë.

Planifikimi i strategjive të shëndetshme dhe sigurimi i një mjedisi mbështetës dhe inkurajues mund të ndikojnë në rritjen e kulturës së shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve në shkollë, si dhe për integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta.

Në planin e përmirësimit sugjerojmë shtimin dhe përfshirjen e aktiviteteve të reja në planin e veprimtarive plotësuese dhe jashtëshkollore, që lidhen me sjelljet e shëndetshme.

Propozimi mbi aktivitetet e reja, është shoqëruar me skenarë mbi mënyrën se si këto aktivitet do të zbatohen në praktikë, duke marrë parasysh në çdo rast strukturat, kapacitetet dhe burimet në dispozicion në nivel vendor. Ky kalendar është i përfshirë në mënyrë të detajuar në pjesën e aneksit A të këtij dokumenti, ku gjendet informacioni i nevojshëm për periudhat dhe aktivitetet e planifikuara.

Hartimi i kalendarit të aktiviteteve, u zhvillua duke mbajtur parasysh parimet e mëposhtme:

- qartësia dhe fleksibiliteti i ndërhyrjeve.
- përgjegjësitë, gjithëpërfshirja dhe konsultimi i ndërhyrjeve.
- shpërndarja e planit në grupet e interesit.
- bashkëpunimi dhe koordinimi.
- koherenca.

1.1 Qëllimi

Qëllimi i hartimit të Planit të Përmirësimit është të sigurojë bashkërendimin e punës mes tre institucioneve: Bashkisë, ZVAP dhe Qendrat Shëndetësore, duke inkurajuar një koordinim më të efektshëm ndërmjet tyre. Kjo do të mundësojë zhvillimin e aktiviteteve në mënyrë më të organizuar dhe me një bashkëpunim më të ngushtë, për të arritur rezultate më të mira dhe për të përmirësuar efikasitetin në realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

Hartimi i këtij plani ka ardhur si rrjedhojë e identifikimit të nevojave për:

- Ofrimin e një qasjeje sistemike, të strukturuar, strategjike dhe të qëndrueshme për promovimin e sjelljeve të shëndetshme dhe krijimin e një kulture shëndetësore në shkolla.
- Identifikim i prioriteteve: ZVAP identifikon fushat më të rëndësishme për përmirësim bazuar në të dhëna dhe evidenca, si dhe prioritizon bazuar në strukturat, kapacitetet dhe burimet aktuale në dispozicion.
- Pajtueshmëria me Standardet Kombëtare: në fushën e Arsimit dhe Shëndetësisë, por edhe në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe rekomandimet e OBSH lidhur me programet e promocionit shëndetësor në shkolla.
- Qëllimi dhe objektivat specifike që ZVAP dëshiron/duhet të arrijë në lidhje me promovimin e sjelljeve të shëndetshme. Përpjekjet janë të synuara drejt një rezultati specifik.
- Sigurimi i transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies: shkollat janë përgjegjëse për zbatimin e objektivave të identifikuara dhe arritjen e rezultateve të dëshiruara. Ndërhyrja është e qëndrueshme dhe progresi matet.
- Angazhim proaktiv i të gjitha palëve të interesuara: nxënësit, prindërit, mësuesit, shërbimit psikosocial dhe ai shëndetësor i shkollës dhe anëtarët e komunitetit angazhohen në promovimin e sjelljeve të shëndetshme.

Të gjithë punojnë së bashku drejt një qëllimi të përbashkët: shëndeti dhe mirëqenia e nxënësve!

1.2 Vizioni

Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies në Arsimin Bazë, nëpërmjet forcimit dhe përmirësimit të shërbimeve të promocionit shëndetësor në shkolla, shtimit të aktviteteve dhe veprimtarive mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme, si dhe bashkëveprimin dhe fuqizimin e lidhjeve të shkollës me komunitetin në tërësi për t'iu përgjigur nevojave të fëmijëve në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur.

1.3 Misioni

Shtimi dhe përmirësimi i gamës dhe cilësisë së programeve dhe aktiviteteve të promocionit shëndetësor me fokus promovimin e shëndetit dhe mirëqenies për çdo fëmijë të arsimit bazë.

1.4 Objektivat

- Forcimi i edukimit shëndetësor: nxënësit, mësuesit dhe drejtorët e shkollave promovojnë sjellje të shëndetshme, masat e duhura të higjienës e praktikat e sigurta mjedisore dhe angazhohen në krijimin e një mjedisi të shëndetshëm në klasë dhe në shkollë.
- Shtimi i aktiviteteve me fokus sjelljet e shëndetëshme.
- Rritja e ndërveprimit midis institucioneve (ZVAP dhe NJVQV) për promovimin e shëndetit, masave të duhura të higjienës dhe praktikave të sigurta mjedisore në një qasje ndërsektoriale.
- Rritja e pjesëmarrjes së prindërve dhe komunitetit në edukimin shëndetësor.
- Monitorimi dhe vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në përmirësimin e sjelljeve shëndetësore.

2. Veprimet për Planin e Përmirësimit

Plani i përmirësimit u hartua bazuar në tetë komponentët kryesorë të Indeksit Shëndetësor të Shkollave, të evidentuar për vlerësimin e shkollave në aspektin e shëndetit.

1.1 Kapaciteti i shkollës në drejtim të vlerësimit të situatës dhe nevojave shëndetësore dhe mirëqenies.
1.2 Shëndeti dhe mirëqenia si pjesë e planeve të shkollës
1.3 Mjedisi fizik në shkollëne
1.4 Mjedisi social në shkollë
1.5 Nxitja e aftësive për përmirësimin e shëndetit
1.6 Lidhja e shkollës me komunitetin e prindërve dhe më gjerë
1.7 Stafi i shkollës
1.8 Menaxhimi i procesit të promocionit të shëndetit dhe mirëqenies nga shkolla

Për tu njohur më shumë me situatën aktuale të shkollave nën administrimin e ZVAP Dimal, u përdorën të dhënat e gjeneruar prej **Instrumenti "Vlerësimi Bazë i Shkollës" (BAS).**
BAS është një instrument që është plotësuar në nivel kombëtar nga të gjitha shkollat 9 vjeçare, publike dhe private në Republikën e Shqipërisë, gjatë muajti Dhjetor 2024.
BAS përmban 5 kategori kryesore, të cilat sigurojnë *të dhëna për shkollën, nxënësit, mësuesit, drejtuesit, personelin mbështetës, mjedisin fizik brenda dhe jashtë shkollës, kurrikulën dhe burimet mësimore.*

2.1 Kapaciteti i shkollës në drejtim të vlerësimit të situatës dhe nevojave shëndetësore dhe mirëqenies.

- Shëndeti fizik dhe mirëqenia e fëmijëve
- Shëndeti fizik dhe mirëqenia e stafit
- Shkolla vlerëson sjelljet shëndetësore të nxënësve
- Shkolla identifion nevojat shëndetësore dhe dëshirat e nxënësve dhe stafit mësimor
- Shkolla ka një person përgjegjës për çështjet e shëndetit

2.1.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor: Rritja e kapacitetit të shkollës në drejtim të vleresimit të situatës dhe nevojave shëndetësore dhe mirëqenies.

2.1.2 Nën-Objektiva

- **Nën-Objektivi 1:** Disponimi i dokumentacionit dhe raporteve mbi mirëqenien fizike, psiko-emocionale dhe sociale të nxënësve të shkollave 9 vjeçare në administrimin e ZVAP Dimal.

- **Nën-Objektivi 2:** Disponimi i dokumentacionit dhe raporteve mbi mirëqenien fizike dhe psiko-emocionale dhe sociale të stafit mësimor të shkollave 9 vjeçare në administrimin e ZVAP Dimal.

- **Nën-Objektivi 3:** Shkollat raportojnë tek ZVAP Dimal, konkluzionet e anketimeve/ sondazheve/pyetësorëve të cilat vlerësojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë gjendjen shëndetësore të nxënësve.

- **Nën-Objektivi 4:** Caktimi i koordinatorit të shëndetit në shkolla.

2.1.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	**Fakt 2024-2025**	**Plan 2025-2026**
Përqindja e shkollave që raportojnë mbi mirëqenien fizike të nxënësve.		
Përqindja e shkollave që raportojnë mbi mirëqenien psiko-emocionale të nxënësve.		
Përqindja e shkollave që raportojnë mbi mirëqenien psiko-emocionale të stafit të shkollës.		
Përqindja e shkollave që raportojnë konkluzionet e anketimeve mbi gjendjen shëndetësore të nxënësve.		
Përqindja e psikologëve, punonjësve social në shkolla		
Përqindja e mekëve/infermierve në shkolla		
Përqindja e oficerve të sigurisë në shkolla		
Përqindja e mësuesve ndihmës për numër fëmijësh me aftësi të kufizuara në shkollë		
Përqindja e shkollave që caktojnë koordinator shëndeti		
Përqindja e shkollave që raportojnë aktivitete të promocionit shëndetësor të organizuara/koordinuara nga koordinatori shëndetësor		
Përqindja e shkollave që raportojnë matjet antropometrike tek ZVAP		

2.1.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Disponimi i dokumentacionit dhe raporteve mbi mirqënien fizike të nxënësve nga ZVAP për shkollat që mbulojnë.	Raportimi periodik mbi gjendjen shëndetësore të nxënësve.	Stafi shëndetësor (mjeku/infermieri, dentist)
2.	Disponimi i dokumentacionit dhe raporteve mbi mirqënien psiko-emocionale dhe sociale të nxënësve, nga ZVAP për shkollat që mbulon.	Raportimi periodik mbi gjendjen shëndetësore të nxënësve, sipas udhëzuesit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.	Stafi shëndetësor (psikologu/punonjësi social, mësuesi ndihmës dhe oficeri i sigurisë).
3.	Disponimi i dokumentacionit dhe raporteve mbi mirqënien psiko-emocionale dhe sociale të stafit mësimor, nga ZVA për shkollat që mbulon.	Raportimi periodik mbi gjendjen shëndetësore të nxënësve, sipas udhëzuesit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.	Stafi shëndetësor (psikologu/punonjësi social, mësuesi ndihmës dhe oficeri i sigurisë).
4.	Shkollat raportojnë tek ZVA, konkluzionet e anketimeve/sondazheve/ pyetësorëve të cilat vlerësojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë gjendjen shëndetësore të nxënësve.	Pas çdo pyetësori/ anketimi duhet të raportohet në formë narrative/satististikore konkluzionet e nxjerra, duke ruajtur anonimitetin e nxënësve.	Drejtori i IA
5	Vendosja e një koordinatori shëndeti në çdo shkollë	Në shkollë vendoset një koordinator shëndeti i cili është përgjegjës për koordinimin dhe harmonizimin e përgjithshëm të programeve të promovimit të shëndetit të zbatuara në nivel shkolle.	Drejtori i IA

2.1.5 Lista e projekteve

<table>
<tr><td>Nr. 1</td><td>Projekti: Raportimi periodik nga shkollat tek ZVAP në lidhje me mirëqenien fizike të nxënësve.</td></tr>
<tr><td colspan="2">a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Stafi shëndetësor (mjekë, infermier) duhet të raportojnë në mënyrë periodike mbi të gjitha aktivitetet, që zhvillon me nxënësit me AK. Gjithashtu raportimi i emergjencave të nxënësve në shkolla duhet të jetë i menjëhershëm dhe bazuar në udhëzimet e marra për format e raportimit të tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="2">i. Situata:
Do të duhet të bëhet një raportim periodik mbi aktivitetet që zhvillohen në kuadër të promocionit shëndetësor, vizitave rutinë apo anketimeve/pyetësorëve që stafi shëndetësor zhvillojnë me nxënësit me AK. Drejtuesit e shkollës nuk kanë dokumentacion mbi anketimet apo vizitat shëndetësore që zhvillon stafi i qendrave shëndetësore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Shpeshherë, ka mangësi në raportimin në formë statistikash apo narrative, tek ZVA mbi aktivitetet e zhvilluara në kuadër të promocionit shëndetësor dhe gjendjen shëndetësore të nxënësve në shkolla. Duke mos patur një panoramë të situatës aktuale, të gjendjes shëndetësore të tyre. Ky mos raportim na krijon një hendek në planet për të përmirësuar situatën shëndetësore të nxënësve.</td></tr>
<tr><td colspan="2">ii Synimi i projektit
Duke u bazuar në situaten aktuale të raportimit të shkollave, synohet rritja e numri të raportimeve nga drejtori i IA tek ZVAP.</td></tr>
<tr><td colspan="2">iii Aktivitetet kryesore të projektit
Për çdo aktivitet, vizitë shëndetësore apo pyetësor që stafi shëndetësor zhvillon me nxënësit dhe me nxënësit me aftësi të kufizuara, të dokumentohet, në mënyre narrative apo statistikore, me informacionet kryesore shëndetësore në të.</td></tr>
<tr><td colspan="2">c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)
Drejtuesi i IA të raporton tek ZVAP gjendjen shëndetësore të nxënësve dhe të atyre me AK, si dhe numrin e veprimtarive që zhvillohen në kuadër të përmirësimit dhe të promovimit të shëndetit të nxënësve 6-16 vjeç.</td></tr>
<tr><td>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira)

Mjekë/infermier, Drejtori i IA</td><td>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)</td></tr>
<tr><td>d) Periudha e zbatimit:</td><td>e) Ndjek zbatimin e projektit:</td></tr>
</table>

Nr. 2	**Projekti:** Raportimi periodik nga shkollat tek ZVAP, mbi mirëqenien psiko-emocionale dhe sociale të nxënësve.

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Punonjësit social, psikologët duhet të raportojnë në mënyrë periodike, 3 herë në vit çdo fund periudhë, mbi çdo veprimtari, pyetësorë/sondazhe që zhvillohet me nxënësit, si dhe raportimi i emergjencave të nxënësve në shkolla sipas udhëzuesit për praktikën e punës së shërbimit psiko-social në shkollë.

i. Situata:

Njësia e shërbimit psiko-social ofron aktivitete për përmirësimin e mirëqenies psiko-sociale të nxënësve si këshillim individual, në grup, vlerësim psikologjik, referim pranë shërbimeve, aktivitete psikosociale me nxënësit, etj.

Por jo të gjitha këto aktivitete raportohen sipas formatit standard të udhëzuesit.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Stafi i punonjësve social, psikologët kanë mangësi në raportimin periodik të veprimtarive sipas udhezuesit duke mos patur një panoramë të sitatës aktuale, të mirqenies psiko-emocionale të tyre:

- Matrica e raportimit për veprimtaritë e realizuara
- Raportimi për veprimtaritë parandaluese
- Raporti për aktivitetet vlerësuese

Ky mos raportim na krijon një hendek në planet për të përmirësuar situatën e shëndetit mendor të nxënësve.

ii Synimi i projektit

Në bazë të veprimtarive që shërbimi psiko-social zhvillon me nxënësit të bëhet raportimi periodik, nga ku synohet rritja e numri të raportimeve.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

Çdo aktivitet i zhvilluar të raportohet sipas formatit të paraqitur në udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social në shkollë.

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Drejtuesi i IA të raporton tek ZVAP në lidhje me mirëqenien psiko-emocionale, si dhe numrin e veprimtarive që zhvillohen në kuadër të përmirësimit dhe të promovimit të shëndetit mendor të nxënësve 6-16 vjeç.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira) Punonjësit social, psikologët, Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)

d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

Nr. 3	**Projekti:** Raportimi periodik nga shkollat tek ZVA, mbi mirëqenien psiko-emocionale dhe sociale të stafit mësimor.

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Projekti synon të informojë në mënyrë periodike mirqënien psiko-emocionale të stafit mësimor tek ZVAP, për të identifikuar sfidat, për të përmirësuar mbështetjen dhe për të krijuar një mjedisi pune më të shëndetshëm për mësuesit, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së arsimit.

i Situata:

Njësia e shërbimit psiko-social ofron aktivitete për përmirësimin e mirëqenies psiko-sociale të stafit mësimor si këshillim individual, në grup, vlerësim psikologjik, referim pranë shërbimeve etj. Por jo të gjitha këto aktivitete raportohen sipas formatit standard të udhëzuesit.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Stafi i punonjësve social, psikologët kanë mangësi në raportimin periodik të veprimtarive sipas udhëzuesit duke mos patur një panoramë të sitatës aktuale, të mirëqenies psiko-emocionale të tyre:

- Matrica e raportimit për veprimtaritë e realizuara
- Raportimi për veprimtaritë parandaluese
- Raporti për aktivitetet vlerësuese

Ky mos raportim na krijon një hendek në planet për të përmirësuar situatën e shëndetit mendor të stafit mësimor.

ii Synimi i projektit

Synimi i projektit është të ndihmoj në identifikimin e hershëm të nevojave dhe ofrimin e ndërhyrjeve efektive për përmirësimin e mjedisit të punës dhe performancës profesionale.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

Çdo aktivitet i zhvilluar të raportohet sipas formatit të paraqitur në udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social në shkollë.

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

- Njohja e hershme e sfidave dhe faktorëve që ndikojnë negativisht në mirëqenien e mësuesve.
- Hartimi dhe zbatimi i planeve efektive për ndërhyrje dhe mbështetje të stafit mësimor.
- Përmirësimi i kushteve psiko-sociale, duke rritur motivimin dhe angazhimin e mësuesve.
- Një mjedis pune më i shëndetshëm që ndikon pozitivisht në performancën dhe rezultatet arsimore.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira) Punonjësit social, psikologët, Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)	

d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

Nr. 4	**Projekti:** Zhvillimi i pyetësorit mbi "Karakteristikat e sjelljeve shendetesore tek nxenesit e shkollave" (HBCS) nga psikologu/punonjësi social.

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Çdo vit rekomandohet të zhvillohet pyetësorësori mbi "Karakteristikat e sjelljeve shëndetësore tek nxënësit e shkollave" (HBCS) nga psikologu/punonjësi social.

HBCS është një pyetësor i cili mat vlerësimin e karakteristikave shëndetësore tek fëmijët.

i Situata:

Në shkolla psikologu/punonjësi social zhvillon disa pyetësor në vit me nxënësit, prindërit dhe mësuesit me temë: "Bullizmi" "Dhuna" etj. Megjithatë, sugjerohet që të rritet numri i pyetësorëve që të vlerësojë sjelljet e shëndetshme të nxënësve, njohuritë e tyre mbi konceptet shëndetësore dhe ekspozimin ndaj sjelljeve të rrezikshme. Për këtë arsye, propozohet zhvillimi i pyetësorit HBCS çdo vit.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Psikologët dhe punonjësit socialë luajnë një rol kyç në sigurimin e mirëqenies dhe përmirësimin e sjelljes së nxënësve, duke zhvilluar pyetësorë, anketa dhe intervista me nxënës, prindër dhe mësues për të kuptuar më mirë perspektivat e tyre mbi këto çështje.

Zhvillimi i pyetësorit HBCS çdo vit është i rëndësishëm për:

- Vlerësimin e sjelljeve të shëndetshme dhe njohurive të nxënësve mbi konceptet shëndetësore.
- Identifikimin e ekspozimit ndaj sjelljeve të rrezikshme dhe përcaktimin e masave për përmirësim.
- Promovimin e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm që u jep të rinjve aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për një të ardhme të suksesshme.

Përmirësimi i shëndetit të nxënësve kontribuon në rritjen e kapacitetit për të mësuar, uljen e mungesave dhe rritjen e performancës fizike dhe mendore.

ii Synimi i projektit

Të njohim qartësisht dëshirat dhe nevojat shëndetësore të nxënësve nëpërmjet pyetësorëve, dhe nëpërmjet raportimit ku të dhënat e nxënësve janë konfidenciale.

Ky pyetësor është ndërtuar për:

- të ndihmuar të gjithë fëmijët në përmirsimin e sjelljeve shëndetësore
- të informuar prindërit rreth situatës shëndetësore të fëmijëve të tyre
- të analizuar situatën shëndetsore të nxënësve dhe për të marrë masa për të përmirsusar shëndetin e tyre si dhe për të nxitur sjellje të shëndetshme tek nxënësit nga klasa e 6-9.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

Zhvillimi i pyetësorit mbi vlerësimin e karakteristikave shëndetësore të fëmijëve (HBCS) çdo vit nga psikologu/punonjësi social. Kryerja e pyestësorit mund të bëhet sipas kapaciteteve të shkollave në format letër ose online.

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Prioritizimi i kërkesave dhe përmirësimimi i kushteve aty ku është e arsyeshme, bazuar në dëshirat dhe nevojat shëndetësore të nxënësve në shkollë.	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Psikologu/punonjësi social Nxënësit	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj) Projekti "Shkollat për Shëndetin"
d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

Nr. 5	**Projekti:** Trajnim i mësuesve të edukimit fizik mbi kryerjen e matjeve antropometrike.

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Zhvillimi i trajnimeve për mësuesit e lëndës së edukimit fizik mbi matjet antropometrike, duke përfshirë matjen e gjatësisë, peshës dhe llogaritjen e BMI-së sipas standardeve të përcaktuara.

i Situata:

Në shkolla, mësuesit e edukimit fizik marrin pjesë në trajnime për rritjen e njohurive dhe aftësive të tyre profesionale. Megjithatë, deri më tani nuk është zhvilluar asnjë trajnim i specializuar për kryerjen e matjeve antropometrike sipas standardeve ndërkombëtare apo për llogaritjen e BMI-së.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

- Matjet antropometrike kërkojnë saktësi të lartë, pasi gabime të vogla mund të ndikojnë ndjeshëm në përllogaritjen e BMI-së.
- Mësuesit kanë nevojë për udhëzime dhe mjete të duhura për të realizuar këto matje me standardet e nevojshme.

ii Synimi i projektit

- Rritja e kapaciteteve dhe njohurive të mësuesve të edukimit fizik për kryerjen e matjeve antropometrike në mënyrë të saktë dhe të standardizuar.
- Minimimi i gabimeve në matjet dhe përllogaritjet e BMI-së për nxënësit.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

Zhvillimi i trajnimit: "Matjet antropometrike" me të gjithë mësuesit e lëndës së edukimit fizik, në ciklin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët.

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

- Të gjithë mësuesit e edukimit fizik janë të trajnuar për të kryer matjet antropometrike me saktësi dhe sipas standardeve.
- Zhvillimi i një procesi më të saktë dhe të besueshëm për monitorimin e parametrave shëndetësorë të nxënësve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) - Mësuesit e edukimit fizik - Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj) Zhvillimi i trajnimeve nga projekti Projekti "Shkollat për Shëndetin" ose donator të tjerë.

d) Shpenzimet e llogaritura (për cdo aktivitet të mësipërm pika iii)

Blerja e paisjeve për të realizuar matjet: peshore dixhitale dhe metër

Shpenzimet për cdo aktivitet	**Totali (mijë lekë)**
Shuma:	

e) Periudha e zbatimit:	**f) Ndjek zbatimin e projektit:**

Nr. 6	**Projekti:** Raportimi i matjeve antropometrike

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Ky projekt synon të standardizojë procesin e raportimit të matjeve antropometrike në shkolla. Aktivitetet përfshijnë trajnimin e mësuesve të edukimit fizik për kryerjen e saktë të matjeve (gjatësia, pesha) dhe përllogaritjen e BMI-së, si dhe hartimin e një formati të thjeshtë për raportimin e të dhënave tek ZVAP-ja.

i Situata:

Aktualisht, mësuesit e edukimit fizik realizojnë matje antropometrike në fillim dhe në fund të vitit shkollor (gjatësia, pesha, perimetri i belit dhe vitheve), por:

- Këto të dhëna regjistrohen në regjistra fizikë dhe nuk raportohen tek ZVA-ja.
- BMI-ja nuk përllogaritet dhe mungon standardizimi në dokumentimin e matjeve.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Duhet të krijohet një format raportimi i thjeshtë dhe i standardizuar për të dërguar të dhënat tek ZVAp-ja duke siguruar anonimitetin dhe ruajtjen e privatësisë së nxënësve.

ii Synimi i projektit

Raportimi i matjeve antropometrike dhe BMI-së së nxënësve tek ZVAP, duke përmirësuar cilësinë dhe përdorueshmërinë e të dhënave për analiza të mëtejshme.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

- Plotësimi i një tabele të thjeshtë nga mësuesi i edukimit fizik dhe raportimi i saj nga drejtori i IA tek ZVA-ja, si mëposhtë:

Matja e gjatësisë	**Matja e peshës**	**Llogaritja e BMI**

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

- Dokumentimi i të dhënave antropometrike dhe BMI-së për çdo shkollë në mënyrë të strukturuar.
- Të dhënat e raportuara tek ZVA-ja do të jenë të vlefshme për hulumtime dhe analiza shkencore.
- Identifikimi i trendeve dhe faktorëve të rrezikut për sëmundjet e lidhura me shëndetin e nxënësve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) - Mësuesit e edukimit fizik, Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)

d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

Nr. 7	**Projekti:** Vendosja e një koordinatori shëndeti në shkollë

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Vendosja e një "Koordinatori Shëndeti" në çdo shkollë është një hap i rëndësishëm për të siguruar që të gjitha programet dhe iniciativat për promovimin e shëndetit të jenë të koordinuara dhe të zbatohen në mënyrë efektive. Ky rol synon të forcojë praninë e një personi të dedikuar për harmonizimin e përpjekjeve për përmirësimin e mirëqenies fizike dhe mendore të nxënësve, si dhe për promovimin e sjelljeve të shëndetshme në komunitetin shkollor dhe përtej.

i Situata:

Në nivel ndërkombëtar, programet e promovimit të shëndetit në nivel shkolle koordinohen nga një gamë e gjerë e personelit të shkollës, bazuar në burimet, traditën dhe rregulloret në dispozicion në çdo vend. Prandaj, në nivel global, nuk ka asnjë "standard të artë" për pozicionin (profilin) e një "Koordinatori Shëndetësor" të shkollës, rolin e të cilit mund ta luajë një infermiere e trajnuar, personel tjetër shëndetësor, ose punonjës social.

Roli proaktiv i infermierëve të shkollave në Shqipëri në lidhje me programet e promovimit të shëndetit me fokus të veçantë në nxitjen e sjelljeve të qëndrueshme të shëndetshme tek fëmijët është pothuajse inekzistent. Prandja shihet e domosdoshme vendosja e një koordinatori shëndeti në çdo shkollë.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

- Ka një mungesë të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet sektorëve arsimorë dhe shëndetësorë, ndërsa të dyja institucionet u shërbejnë të njëjtëve fëmijë.
- Ekziston një nevojë urgjente për një person që mund të ndërlidhë shkollën me komunitetin dhe strukturat shëndetësore, duke vendosur fëmijët në qendër të çdo ndërhyrjeje.

<u>Përgjegjësia kryesore e "Koordinatorit Shëndetësor" do të jetë:</u>

- Bashkëpunimi me stafin e shkollës, prindërit, pushtetin lokal dhe njësitë shëndetësore për zbatimin e programeve shëndetësore.
- Promovimi i sjelljeve të shëndetshme në nivel shkolle dhe komuniteti.

ii Synimi i projektit

Fuqizimi i rolit të koordinatorit të shëndetit në shkolla për të promovuar sjellje të shëndetshme tek fëmijët dhe përmes tyre, ndikimi pozitiv në prindërit dhe komunitetet përreth.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

Caktimi i një "Koordinatori Shëndeti" në çdo shkollë.

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Çdo shkollë të ketë një koordinator shëndeti të trajnuar dhe funksional.
Përmirësimi i koordinimit të programeve të shëndetit dhe ndërhyrjeve në shkollë.
Rritja e ndërgjegjësimit dhe adoptimi i sjelljeve të shëndetshme nga nxënësit dhe komunitetet e tyre.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) - ZVAP, Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)

d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

2.2 Shëndeti dhe mirëqenia si pjesë e planeve të shkollës

- Shëndeti fizik dhe mirëqenia e fëmijëve
- Promocioni i shëndetit dhe mirëqenies si pjesë e qëllimeve edukuese të shkollës
- Promocioni i shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve si pjesë e kurrikulës shkollore
- Vizioni i shkollës mbi shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve
- Nxënësit, stafi mësimor/ndihmës nxiten të marrin pjesë në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve shkollore që lidhen me shëndetin dhe mirëqenien
- Shkolla ka protokolle të qarta në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme

2.2.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor:

Qëllimi kryesor është përfshirja e aktiviteteve me synim promocionin shëndetësor në shkolla.

2.2.2 Nën-Objektiva

- **Nën-Objektivi 1:** Shkolla përfshin aktivitete kros/ekstrakurrikulare me fokus shëndetin.
- **Nën-Objektivi 2:** Shkolla përfshin në planin vjetor aktivitete që lidhen me sjelljet e shëndetshme.
- **Nën-Objektivi 3:** Shkolla zhvillon sondazhe që reflektojë qartësisht dëshirat dhe nevojat shëndetësore të nxënësve.
- **Nën-Objektivi 4:** Shkolla trajnon stafin e saj mbi protokollet në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj).
- **Nën-Objektivi 5:** Mundësimi i zbatimit të protokolleve të emergjencës nga ana infrastrukturore.

2.2.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	**Fakt 2024-2025**	**Plan 2025-2026**
Numri i aktiviteteve kros-ekstra-kurrikulare te zhvilluara nga shkollat në kuadër të promocionit shëndetësor.		
Përqindja e shkollave që zhvillon sondazhe që reflektojnë qartësisht dëshirat dhe nevojat e nxënësve.		
Përqindja e stafit që trajnohen mbi shpërthimet epidemike apo fatkeqesi të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj)		

Shkollat kanë protokolle për emergjencat, rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj)		

2.2.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Shkolla përfshin aktivitete kros dhe ekstrakurrikulare me fokus promocionin e shëndetit.	Propozim i shtimit në Planin vjetor të kalendarit të aktiviteteve mbi shtimin e aktiviteteve me fokus promocionin shëndetësor.	ZVA-ja Drejtori i IA
2.	Shkolla zhvillon sondazhe që reflektojë qartësisht dëshirat dhe nevojat shëndetësore të nxënësve	Kryerja e sondazheve nga psikologu/punonjësi social	Drejtori i IA Psikologu/ punonjësi social
3.	Shkolla trajnon stafin e saj mbi protokollet në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj)	Trajnim me donatorë ose në bashkëpunim me institucionet përkatëse, emergjencat civile, njësitë vendore të shëndetit publik etj.	Drejtori IA Donatorë, emergjencat civile ose stafi i qendrave shëndetësore.
4.	Koordinimi, shkëmbimi i informacionit ndërmjet ZVA dhe bashkisë për përmbushjen e kushteve të duhura infrastrukturore, për të mundësuar zbatimin e protokolleve të emergjencës.	Bashkëpunimi i ZVAP dhe bashkisë për të koordinuar punën gjatë inspektimeve të gjendjes infrastrukturore të godinave.	Drejtori i IA ZVAP Bashkia

2.2.5 Lista e projekteve

<table>
<tr><td>Nr. 1</td><td>Projekti: Zhvillimi i trajnimeve për protokollet në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj)</td></tr>
<tr><td colspan="2">a)Përshkrim i shkurtër i projektit:
Ky projekt synon të trajnojë stafin e shkollës për zbatimin e protokolleve në rastet e emergjencave si shpërthimet epidemike, tërmetet, zjarret dhe përmbytjet. Trajnimet do të ndihmojnë në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve, përgatitjen e planeve emergjente dhe forcimin e aftësive për të ndërhyrë në situata kritike.</td></tr>
<tr><td colspan="2">i. Situata:
• Shkollat disponojnë protokolle emergjente, por stafi nuk trajnohet rregullisht për zbatimin e tyre.
• Rreziku nga fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat shëndetësore mbetet i lartë për shkak të mungesës së njohurive dhe aftësive praktike të stafit.
Në Dimal, nga 16 shkolla të cilat kanë plotësuar BAS vetëm 5 shkolla kanë deklaruar se kanë shkallë emergjence në raste të ndryshme që lidhen me situatat emergjente. Gjithashtu, lidhur me pajisjet si fikse zjarri, mund të themi se 14 shkolla janë shprehur se janë të pajisura me fikse zjarri.</td></tr>
<tr><td colspan="2">b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim
• Përgatitja e stafit për të zbatuar protokollet emergjente është jetike për të siguruar mbrojtjen e nxënësve dhe komunitetit shkollor.
• Përfshirja e trajnimeve praktike është thelbësore për krijimin e një kulture të sigurisë institucionale.</td></tr>
<tr><td colspan="2">ii Synimi i projektit
Rritje kapaciteti të stafit të shkollës për menaxhimin e emergjencave synon ta shndërrojë shkollën në një komunitet të nxëni të orientuar drejt krijimit të një kulture të sigurisë institucionale.</td></tr>
<tr><td colspan="2">iii Aktivitetet kryesore të projektit
Zhvillimi i trajnimeve mbi protokollet e shpërthimve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme me stafin e shkollës.</td></tr>
<tr><td colspan="2">c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)
Në përfundim të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë të aftë të:
• Identifikojnë dhe përballojnë situatat emergjente nga përmbytjet, zjarret dhe tërmetet.
• Shpjegojnë rëndësinë e mbrojtjes dhe sigurisë në raste emergjente.
• Vlerësojnë mjedisin fizik të shkollës dhe të ndërmarrin masa parandaluese.
• Hartojnë dhe zbatojnë plane trajnimi për nxënësit në raste shpëtimi.
• Monitorojnë dhe vlerësojnë masat edukative për përmirësimin e sigurisë në shkollë.</td></tr>
<tr><td>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)
ZAVP
Bashkia- zyra e emergjencave civile
Drejtori i IA</td><td>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)
Donator, OJF, Kryqi i kuq etj.</td></tr>
<tr><td>d) Periudha e zbatimit:
Viti akademik</td><td>e) Ndjek zbatimin e projektit:
ZVAP</td></tr>
</table>

Nr. 2	Projekti: Hartimi i unifikuar i kalendarit të aktiviteteve ndërinstitucional.

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Projekti "Shkollat për Shëndetin" ka hartuar "Kalendarin e aktiviteteve" i cili ndodhet në aneksin A të këtij plani dhe një "Udhëzues për hartimin e kalendarit të aktiviteteve në institucionet arsimore parauniversitare" i cili ndodhet në aneksin B të këtij dokumenti. Në këtë udhëzues jepen shembuj konkretë të veprimtarive mbi sjelljet e shëndetshme në nivel shkolle ose në nivel klase. Gjithashtu në fund të udhëzuesit ka modele të planeve të veprimtarive plotësuese dhe jashtëshkollore për tema specifike për promovimin e sjelljeve të shëndetshme.

i. Situata:

Shkollat nuk përfshijnë mjaftueshëm aktivitete që nxisin sjelljet e shëndetshme në planin e tyre të veprimtarive.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Edukimi i sjelljeve të shëndetshme që në fëmijëri ndihmon nxënësit të zhvillojnë zakone të shëndetshme afatgjata. Por në shumë shkolla mungon një plan i qartë për përfshirjen e këtyre aktiviteteve. Përgatitja e mësuesve dhe drejtuesve mbi këto tema është thelbësore për t'i zbatuar në mënyrë të suksesshme.

Udhëzuesi do të përfshijë njohuri mbi:

- Zakonet e të ushqyerjes.
- Aktivitetin fizik.
- Parandalimin e përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogave.
- Promovimin e shëndetit seksual, mendor dhe higjienës personale.
- Masat për parandalimin e sëmundjeve infektive, përfshirë edhe Covid-19.

Të gjitha aktivitetet janë të përshtatshme për t'u zbatuar në shkolla me infrastruktura dhe kapacitete të ndryshme. Ato synojnë përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe komunitetit për krijimin e një kulture të sjelljeve të shëndetshme.

ii Synimi i projektit

- Planifikimi dhe realizimi i aktiviteteve për praktikimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.
- Ndërgjegjësimi i komunitetit lokal për rëndësinë e sjelljeve të shëndetshme.
- Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet nxënësve, mësuesve, prindërve dhe komunitetit në aktivitete edukuese.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

- Ndarja e kalendarit të aktiviteteve tek të gjitha institucionet ZVAP; Qendrat e shëndetit; Bashki
- Dakordësimi i përmbajtjes së kalendarit
- Publikimi i aktiviteteve të përbashkëta në Gazetën Elektronike e cila do të zhvillohet në fazën e dytë në mbështetje të projektit SHPSH.

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

- Rritja e përfshirjes së aktiviteteve të propozuara në planet vjetore të shkollave.
- Edukimi i nxënësve dhe mësuesve mbi rëndësinë e sjelljeve të shëndetshme.
- Ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit për të mbështetur këto iniciativa.
- Rritja e koordinimit ndërmjet institucioneve për të rakorduar aktivitete

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) ZVA Bashki Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)
d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

2.3 Mjedisi fizik në shkollë

- Mjediset shkollore janë “miqësore” për fëmijët, të sigurta, të pastra dhe nxisin higjenën personale për të githë nxënësit
- Mjediset shkollore janë të përshtatshme për nxënësit, sipas moshës dhe gjinisë, si dhe për nxënësit me aftësi të kufizuara
- Mjdiset shkollore janë të hapuar për aktivitete pas orëve të mësimit
- Mjediset shkollore mundësojnë distancimin fizik
- Përmbushja e standardeve zyrtare të mjediseve shkollore
- Siguria përreth dhe brenda shkollës
- Ventilimi (ajrosja), ndriçimi dhe temperatura e mjediseve shkollore
- Pijet dhe ushqimet e shëndetshme në mjediset e shkollës

2.3.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor:

Përmirësimi i mjediseve fizike të shkollës për fëmijët, duke garantuar siguri, higjenë dhe përmushjen e kushteve të nevojshme për të nxënë.

2.3.2 Nën-Objektiva

- **Nën-Objektivi 1:** Shkolla ofron mjedise të sigurta dhe miqësore për nxënësit
- **Nën-Objektivi 2:** Shkolla lejon përdorimin e mjediseve të shkollës, për përdorim pas orarit mësimor
- **Nën-Objektivi 3:** Shkollat kanë klasa të profilizuar në sport.

2.3.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	**Fakt 2024-2025**	**Plan 2025-2026**
Përqindja e shkollave që lejojnë përdorimin e mjediseve të shkollës pas orarit mësimor, për nxitjen e aktivitetit fizik.		
Përqindja e shkollave që kanë krijuar klasa sportive.		
Përqindja e nxënësve që përfitojnë nga klasat sportive.		
Përqindja e djemve që kanë marrë pjesë në klasat sportive.		
Përqindja e vajzave që kanë marrë pjesë në klasat sportive.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në klasat sportive nga zona urbane.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në klasat sportive nga zona rurale.		
Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuar që kanë marrë pjesë në klasat sportive.		
Përqindja e nxënësve rom/egjiptian që kanë marrë pjesë në klasat sportive.		

2.3.4 Lista e veprimeve

Nr.	**Nën-objektivi**	**Veprimi**	**Përgjegjës**
1.	Shkolla lejon përdorimin e mjediseve të shkollës, për përdorim pas orarit mësimor	Hartimi i një plani për shfrytësimin e ambjenteve sportive të shkollës bashkë me mësuesit e lëndës së edukimit fizik.	Drejtori i IA Mësuesit e lëndës edukim fizik
2.	Shkollat kanë klasa të profilizuar në sport.	Raportimi i aktiviteteve që kryejnë klasat sportive dhe i numrit të nxënësve që përfitojnë na këto klasa.	Mësuesit e lëndës edukim fizik

2.3.5 Lista e projekteve

<table>
<tr><td>Nr. 1</td><td>Projekti: Raportimi i aktiviteteve që kryejnë klasat sportive dhe i numrit të nxënësve.</td></tr>
<tr><td colspan="2">a) Përshkrim i shkurtër i projektit:
Shkollat që aktualisht nuk kanë klasa të profilizuara në sport duhet të krijojnë mundësi për zhvillimin e tyre, duke përfshirë sporte si gjimnastikë, atletikë, dhe të tjera. Krahas kësaj, duhet të raportohet numri i nxënësve të përfshirë në këto aktivitete dhe të përshkruhet natyra e tyre.
Në Dimal nga 16 shkolla të cilat kanë plotësuar BAS, vetëm 5 prej tyre kanë shprehur se kanë klube/ekip sportive në shkollë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">i Situata:
Vihet re një rënie e numrit të shkollave ku janë hapur dhe funksionojnë klasat e profilizuara në sport, kjo si rrjedhojë e situatës së krijuar nga tërmeti i nëntorit 2019.</td></tr>
<tr><td colspan="2">b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Hapja e klasave sportive duhet të realizohet në përputhje me urdhrin nr. 440, datë 2.05.2018, "Për hapjen e klasave të profilizuara në sport në shkollat e arsimit bazë të sistemit parauniversitar".
Një raportim i rregullt i numrit të nxënësve pjesëmarrës dhe aktiviteteve të zhvilluara është thelbësor për vlerësimin e suksesit të këtij programi.</td></tr>
<tr><td colspan="2">ii Synimi i projektit
Të rritet përfshirja e nxënësve në klasat sportive, duke promovuar një mënyrë jetese të shëndetshme dhe aktivitetin fizik si pjesë integrale e zhvillimit të tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="2">iii Aktivitetet kryesore të projektit
• Hapja e klasave sportive në shkollat që nuk kanë të tilla.
• Raportimi periodik i numrit të nxënësve pjesëmarrës në klasat sportive.
• Përshkrimi dhe dokumentimi i aktiviteteve të zhvilluara.
• Organizimi i garave sportive ndërmjet klasave dhe shkollave për promovimin e sportit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)
• Përfshirja e të paktën 80% të nxënësve në klasat sportive në shkollat ku ato funksionojnë.
• Raporte të detajuara për numrin e nxënësve dhe aktivitetet e zhvilluara, të dorëzuara nga shkollat në intervale kohore të përcaktuara.
• Rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e aktivitetit fizik në komunitetin shkollor.
• Krijimi i një kulture të re sportive në shkollat e përfshira.</td></tr>
<tr><td>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)
Drejtori i IA
Mësuesi i edukimit fizik dhe shëndetit dhe sportit.</td><td>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)
Bashkia</td></tr>
<tr><td>d) Periudha e zbatimit:</td><td>e) Ndjek zbatimin e projektit:</td></tr>
</table>

Nr. 2	**Projekti:** Hartimi i një plani për shfrytësimin e ambjenteve sportive të shkollës.

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Shkollat që disponojnë ambiente sportive, si palestra apo fusha loje, mund të hartojnë një plan të përbashkët me mësuesit e edukimit fizik dhe bashkinë për t'i shfrytëzuar pas përfundimit të orarit mësimor.

i. Situata:

Shumë shkolla nuk i shfrytëzojnë mjediset sportive për nxënësit ose për fëmijët e komunitetit përreth, edhe pse këto hapësira janë thelbësore për nxitjen e aktiviteteve fizike dhe sociale.
Në Dimal, nga 16 shkolla të cilat plotësuan BAS, rezulton se vetëm 1 prej tyre ka palestër për organizimin e orëve të sportit. Shkolla tjetër, ka një mungesë të këtyre ambienteve mirëpo sipas të dhënave rezulton se të 16 shkollat kanë oborr dhe vetëm 10 prej tyre kanë rrethim të jashtëm.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Sipas Ligjit Nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës," në Nenin 19, mbi të drejtën për pushim dhe argëtime kulturore e sportive, theksohet:

- Krijimi i hapësirave të përshtatshme për ushtrimin e sigurt dhe gjithëpërfshirës të veprimtarive sportive, kulturore dhe dëfryese në mjediset shkollore dhe komunitare.
- Hartimi i kurrikulave shkollore që krijojnë mundësi për lojëra, çlodhje dhe aktivitete sportive.

Shkolla duhet të funksionojë si një qendër komunitare që forcon identitetin dhe bashkëpunimin e grupit. Hapësirat si fushat sportive, palestra, bibliotekat, dhe laboratorët duhet të jenë të aksesueshme për komunitetin, sipas rregullave dhe kufizimeve të përcaktuara.

ii Synimi i projektit

- Motivimi dhe nxitja e nxënësve dhe fëmijëve të komunitetit për të marrë pjesë në aktivitete fizike jashtë orarit mësimor.
- Përmirësimi i mirëqenies fizike dhe mendore të pjesëmarrësve duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e një jetese aktive.
- Krijimi i një strategjie që inkurajon bashkëpunimin, të mësuarin ndërdisiplinar dhe krijimin e projekteve që angazhojnë nxënësit për të lëvizur, punuar në grup dhe për të qenë aktivë.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

- Hartimi i një plani për shfrytëzimin e ambienteve sportive nga drejtoria e shkollës në bashkëpunim me mësuesit e edukimit fizik.
- Mundësimi i shfrytëzimit të këtyre ambienteve nga fëmijët e komunitetit për një pagesë simbolike, me qëllim mbulimin e kostove të mirëmbajtjes.
- Marrja e lejeve përkatëse nga Bashkia, në përputhje me legjislacionin.
- Organizimi i aktiviteteve sportive jashtë orarit mësimor, në mënyrë të sigurt dhe gjithëpërfshirëse.

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

- Krijimi i një marrëdhënieje të shëndetshme midis shkollës dhe komunitetit përmes aktiviteteve të përbashkëta.
- Nxitja e një jetese aktive dhe të shëndetshme për fëmijët e shkollës dhe komunitetit përreth.
- Përdorimi më efikas i hapësirave sportive si një burim për zhvillimin social dhe fizik.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Drejtori i IA Mësuesi i edukimit fizik dhe shëndet	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj) Bashkia Komuniteti
d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

2.4 Mjedisi social në shkollë

- Projektimi i mjediseve të shkollës
- Aktivitetet e ofruara nga shkolla që kanë si qëllim edhe promovimin e shëndetit dhe mirëqenien e nxënësve
- Përfshirja në programet jashtë-shkollore të aktiviteteve edukuese dhe promovuese të shëndetit
- Atmosfera miqësore në shkollë
- Prania e një individi të besuar për nxënxësit
- Punonjësi shëndetësor në shkollë
- Mbështetja për nxënësit me aftësi të kufizuar
- Identifikimi dhe referimi i nxënësve me aftësi të kufizuara

2.4.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor:

Shkollat kanë si qëllim promovimin e shëndetit dhe mirëqenien e nxënësve**.** Shndërrimi i shkollave në mjedise miqësore dhe jo abuzuese për fëmijët.

2.4.2 Nën-Objektiva

- **Nën-Objektivi 1:** Shkolla si mjedis miqësor për fëmijët
- **Nën-Objektivi 2:** Përfshirja në programet jashtë-shkollore të aktiviteteve edukuese dhe promovuese të shëndetit
- **Nën-Objektivi 3:** Përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit

2.4.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	**Fakt 2024-2025**	**Plan 2025-2026**
Përqindja e nxënësve që marrin pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit.		
Përqindja e djemve që kanë marrë pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit.		

Përqindja e vajzave që kanë marrë pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitetete edukuese dhe promovuese të shëndetit nga zona urbane.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit nga zona rurale.		
Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuar që kanë marrë pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit.		
Përqindja e nxënësve rom/egjiptian që kanë marrë pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit.		

2.4.4 Lista e veprimeve

Nr.	**Nën-objektivi**	**Veprimi**	**Përgjegjës**
1.	Shkolla si mjedis miqësor për fëmijët	Sigurimi i një atmosfere miqësore dhe të sigurt për fëmijët.	Drejtori i IA ZVAP

2.4.5 Lista e projekteve

<table>
<tr><td>Nr. 1</td><td>Projekti: Shkolla si mjedis miqësor për fëmijët</td></tr>
<tr><td colspan="2">a) Përshkrim i shkurtër i projektit:
Organizimi i hapësirave shkollore është një aspekt thelbësor për të garantuar një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët. Ky projekt fokusohet te përmirësimi i ndërtesave, klasave, ambienteve të jashtme dhe kushteve të tjera si ndriçimi, siguria e tualeteve, dhe lehtësirat për zhvillimin e aktiviteteve shkollore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">i Situata:
Ka shkolla të cilat nuk kanë ndriçim të mirë, banjat nuk kanë shul por janë me çelës dhe rrezikojnë ngecjen e nxënësve brenda. Jo të gjitha shkollat kanë hapësira ku nxënësit mund të marrin shërbime, të zhvillojnë aktivitete në mjedise të hapura pa pengesa.</td></tr>
<tr><td colspan="2">b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Mjedisi miqësor, i sigurt, i pa-dhunshëm dhe jo diskriminues nënkupton krijimin e klimës pozitive në shkollë që kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin fizik, social, emocional për të gjithë fëmijët. Për më tepër klima pozitive shkollore mund të çojë në ulje të mungesave, të shërbejë si një metodë e parandalimit të dukurive negative dhe të zvogëlojë efektet e pabarazive socio-ekonomike. Shkollat mjedis të tillë, minimizojnë rastet e dhunës, ka më pak ngacmim dhe arrijnë rezultate më të mëdha akademike.</td></tr>
<tr><td colspan="2">ii Synimi i projektit
Krijimi i ambienteve të sigurta, jo-abuzues, atraktiv dhe stimulues që sigurojnë mirëqenie për fëmijët. Sigurimi i një ambienti që redukton dhunën, minimizon ngacmimet dhe kontribuon në arritjet e përgjithshme të nxënësve.</td></tr>
<tr><td colspan="2">iii Aktivitetet kryesore të projektit
Organizimi i hapësirave shkollore:
- Të sigurohet ndriçim i mirë në të gjitha ambientet shkollore, duke përfshirë klasat, korridoret, parkingjet dhe oborret e shkollës, për të rritur sigurinë dhe lehtësuar mbikëqyrjen.
- Dyert e tualeteve të jenë të dizajnuara në mënyrë që të hapen nga brenda pa çelës, për të parandaluar incidente të mbylljes së fëmijëve.
- Eliminimi i elementëve që kufizojnë dukshmërinë, si perdet ose barrierat në hapësirat ku fëmijët marrin shërbime.</td></tr>
<tr><td colspan="2">c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)
Kjo do të rrisë mirëqenien dhe motivimin e nxënësve, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi pozitiv, gjithëpërfshirës dhe mbështetës, që redukton dhunën dhe ngacmimet, ndërsa përmirëson arritjet akademike dhe cilësinë e jetës në shkollë.</td></tr>
<tr><td>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)

Drejtori i IA</td><td>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)</td></tr>
<tr><td>d) Periudha e zbatimit:</td><td>e) Ndjek zbatimin e projektit:</td></tr>
</table>

2.5 Nxitja e aftësive për përmirësimin e shëndetit

- Shkolla zbaton programe që nxisin zhvillimin e aftësive individuale dhe përvetësimin e njohurive mbi shëndetin
- Shkolla ka rregulla të qarta që nxisin sjellje të shëndetshme

2.5.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor: Të nxiti aftësitë e nxënësve për të përmirësuar shëndetin në shkollë.

2.5.2 Nën-Objektiva

- **Nën-Objektivi 1:** Zhvillimi i aktiviteteve për edukimin bashkëmoshatar (peer-to-peer education) ku nxënësit edukojnë njër-tjetrin.

- **Nën-Objektivi 2:** Hartimi i rregullores që nxit sjellje të shëndetshme.

2.5.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	**Fakt 2024-2025**	**Plan 2025-2026**
Përqindja e nxënësve që marrin pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar		
Përqindja e djemve që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar		
Përqindja e vajzave që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar nga zona urbane.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar nga zona rurale.		
Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuar që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar.		
Përqindja e nxënësve rom/egjiptian që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar.		
Hartimi i një rregulloreje mbi sjelljet e shëndetshme në shkollë		

2.5.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Zhvillimi i aktiviteteve për edukimin bashkëmoshatar (peer-to-peer education) ku nxënësit edukojnë njër-tjetrin.	Mësuesit organizojnë nxënësit, për të zhvilluar aktivitete ku nxënësit kryejnë edukim bashkëmoshatar.	Mësuesit dhe nxënësit
2.	Shkolla ka një rregullore që nxit nxënësit drejt sjelljeve të shëndetshme.	Hartimi i rregullores që nxit sjellje të shëndetshme në shkollë.	Drejtori i IA, mësuesit dhe nxënësit

2.5.5 Lista e projekteve

Nr. 1	**Projekti:** Edukimi bashkëmoshatar (peer-to-peer education)
a) Përshkrim i shkurtër i projektit: Edukimi mes bashkëmoshatarëve mbështetet në idenë se "të rinjtë janë ekspertë të jetës së tyre dhe për këtë arsye janë pikënisja më e mirë në çdo proces mësimor".	
i. Situata: Në shkolla, edukimi mbi sjelljet e shëndetshme është një proces i dominuar nga mësuesit, ku ata shpjegojnë dhe ndajnë informacionin me nxënësit. Deri tani, nuk ka pasur një metodologji ku vetë nxënësit të jenë edukatorë të bashkëmoshatarëve të tyre mbi sjelljet e shëndetshme. Në Dimal nga 16 shkolla të cilat kanë plotësuar BAS, 15 prej tyre janë shprehur se zhvillojnë veprimtari kroskurrikulare me fokus ushqyerjen dhe aktivitetin fizik, si dhe të gjitha shkollat zhvillojnë projekte kurrikulare me fokus shëndetin, ushqyerjen dhe aktivitetin fizik.	
b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Një ndër format më të mira për të mësuar mbi sjelljet e shëndetshme është nëpërmjet përvojave nga njëri-tjetri, në këtë mënyrë nxënësit bëhen edukatorë të bashkëmoshatarëve dhe inkurajohen që t'ua përcjellin informacionin të tjerëve në mënyrë që të gjenerojnë ndryshim midis anëtarëve të tjerë të të njëjtit grup.	
ii Synimi i projektit Të edukojmë fëmijët mbi sjelljet e shëndetshme nëpërmjet përvojave dhe eksperiencave të ndara midis njëri-tjetrit.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit • Organizimi i grupeve të nxënësve pas orës mësimore ose gjatë orëve të lira, me ndihmën dhe mbështetjen e mësuesve. • Zhvillimi i temave mbi sjelljet e shëndetshme, ku nxënësit shpjegojnë dhe ndajnë përvojat e tyre. • Promovimi i shëndetit në shkollë përmes aktiviteteve praktike dhe ndërvepruese, ku nxënësit bëhen liderë në edukimin e bashkëmoshatarëve të tyre.	
c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) Rritje të kapaciteteve dhe njohurive të nxënësve mbi sjelljet e shëndetshme dhe promovimin e shëndetit nëpërmjet edukimit bashkëmoshatar. Si dhe një përfshirje të madhe të nxënësve në këto aktivitete.	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Drejtori i IA, Nxënësit	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)
d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

Nr. 2	**Projekti:** Hartimi i një dokumenti që nxit sjellje të shëndetshme në shkollë.

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Ky projekt synon hartimin e një dokumenti për nxitjen e sjelljeve të shëndetshme në shkolla, përmes bashkëpunimit të aktorëve kryesorë, si mësuesit, psikologët, komisioni i shëndetit, oficerët e sigurisë, qeveria e nxënësve dhe këshilli i prindërve.

i. Situata:

Në një pjesë të shkollave mungon një dokument i hartuar nga vetë nxënësit i dedikuar sjellejeve të shëndetshme, të cila ndalojë dukurit jo të shëndetshme (si dhuna, abuzimi etj) dhe nxit fëmijët drejt promovimit të shëndetit.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

- Nevoja për rregulla të qarta dhe të monitoruara që ndalojnë dukuritë jo të shëndetshme.
- Krijimi i një kornize që përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit shkollor.
- Përfshirja e aktiviteteve jashtëkurrikulare, si debate, aktivitete artistike dhe ligjërata që promovojnë sjellje të shëndetshme dhe dënojnë dukuritë e dëmshme.

ii Synimi i projektit

Shkolla duhet të ketë një rregullore e cila ndalon dhunën dhe abuzimin midis nxënësve si dhe të nxit sjelllje të shëndetshme, si psh ndalimi i konsumit të pijeve të gazuara apo me sheqer në ambientet e shkollës.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

- Bashkëpunimi i mësuesve, psikologëve, oficerëve të sigurisë, qeverisë së nxënësve dhe prindërve për hartimin e rregullores.
- Përfshirja e nxënësve dhe komunitetit në aktivitete edukative që promovojnë zbatimin e rregullores.

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Zbatimi i rregullores do të nxisë sjellje të shëndetshme te nxënësit dhe do të ndihmojë mësuesit në monitorimin më të lehtë të këtyre sjelljeve. Si rezultat, do të krijohet një mjedis shkollor më i sigurt, që redukton dukuritë e dëmshme dhe promovon mirëqenien e përgjithshme.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Nxënësit, mësuesit.	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)

d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

2.6 Lidhja e shkollës me komunitetin e prindërve dhe më gjerë

- Pjesëmarrja dhe perfshirja e prindërve
- Lidhja e shkollës me biznese lokale, klube sportive lokale, dhe me Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetsor
- Organizimi i vizitave tek bizneset lokale për të forcuar sjelljet e shëndetshme

2.6.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor:

Përfshirja e prindërve dhe më gjerë në aktivitetet që zhvillon shkolla mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme.

2.6.2 Nën-Objektiva

- **Nën-Objektivi 1:** Fuqizimi i strukturave të Prindërve në çdo shkollë dhe pjesmarrja aktive e prindërve në aktivitet që zhvillon shkolla.
- **Nën-Objektivi 2:** Lidhja e shkollës me Qendrat e shëndetit për zhvillimin e aktiviteteve mbi sjelljet e shëndetshme.
- **Nën-Objektivi 3:** Organizimi i aktiviteteve në komunitet për të forcuar sjelljet e shëndetshme.

2.6.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	**Fakt 2024-2025**	**Plan 2025-2026**
Përqindja e shkollave që kanë fuqizuar strukturat e prindërve.		
Numri i aktiviteteve që zhvillon bordi i prindërve në zonat urbane në vit.		
Numri i aktiviteteve që zhvillon bordi i prindërve në zonat rurale në vit.		
Numri i aktiviteteve që zhvillon komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit në zonat urbane në vit.		

Numri i aktiviteteve që zhvillon komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit në zonat rurale në vit.		
Numri i aktiviteteve që Qëndrat e Shëndetit kanë zhvilluar me shkollat.		
Numri i aktiviteteve që janë organizuar në komunitet për të forcuar sjelljet e shëndetshme.		
Përqindja e djemve që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet.		
Përqindja e vajzave që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë nga zona urbane dhe nga zona rurale.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet nga zona urbane.		
Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuar që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet.		
Përqindja e nxënësve rom/egjiptian që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet.		

2.6.4 Lista e veprimeve

Nr.	**Nën-objektivi**	**Veprimi**	**Përgjegjës**
1.	Fuqizimi i strukturave të prindërve në çdo shkollë dhe pjesmarrja aktive e prindërve në çdo aktivitet që zhvillon shkolla.	Shkollat ngrenë Bordin e prindërve dhe marrin pjesë në aktivitet që shkolla zhvillon me fokus sjelljet e shëndetshme	Drejtori i IA Prindërit
2.	Lidhja e shkollës me qëndrat shëndetësore për zhvillimin e aktiviteteve mbi sjelljet e shëndetshme.	Shkolla bashkëpunon me qendrat shëndetësore për organizimin e aktiviteteve me fokus shëndetin	Drejtori i IA Qendrat Shëndetësore
3.	Organizimi i aktiviteteve në komunitet për të forcuar sjelljet e shëndetshme	Shkolla bashkëpunon me komunitetin përreth, biznese, klube sportive etj për të organizuar aktivitete për të nxitur nxënësit të qëndrojnë të shëndetshëm.	Drejtori i IA Komuniteti

2.6.5 Lista e projekteve

<table>
<tr><td>Nr. 1</td><td>Projekti: Fuqizimi i strukturave të prindërve në çdo shkollë dhe pjesmarrja aktive e prindërve në aktivitet që zhvillon shkolla.</td></tr>
<tr><td colspan="2">a) Përshkrim i shkurtër i projektit:
Fuqizimi i strukturave të prindërve në shkolla duke i përfshirë ata në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet që organizon shkolla. Ky angazhim do të kontribuojë në krijimin e një partneriteti efektiv mes shkollës, prindërve dhe nxënësve, duke rritur mbështetjen për edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve.</td></tr>
<tr><td colspan="2">i Situata:
• Në shumë shkolla, prindërit nuk janë të përfshirë aktivisht në aktivitetet arsimore ose vendimmarrëse.
• Strukturat e prindërve janë të dobëta ose ekzistojnë vetëm në mënyrë formale, pa ndikuar realisht në funksionimin e shkollës.
• Mungesa e bashkëpunimit të ngushtë midis prindërve dhe stafit shkollor ndikon negativisht në zhvillimin e përgjithshëm të nxënësve.</td></tr>
<tr><td colspan="2">b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Strukturat e prindërve, konkretisht Bordi i Prindërve, duhet të zhvillojë minimumi 3 mbledhje në vit, ku prindërit të jetë pjesmarrës aktiv në të gjitha aktivitetet që shkolla zhvillon me fokus shëndetin. Pjesë e bordit duhet të jetë një anëtar nga komuniteti, gjatë përzgjedhjes së këtij anëtari, mund ti jepet prioritet një personi që mund të jetë mjek, infermier, psikolog/ punonjës social, policë, zjarrfikës etj, pasi ata mund të ofrohen të zhvillojnë orë të lira me nxënësit mbi sjelljet e shëndetshme.</td></tr>
<tr><td colspan="2">ii Synimi i projektit
• Krijimin e strukturave funksionale të prindërve në çdo shkollë.
• Rritjen e pjesëmarrjes aktive të prindërve në aktivitetet e shkollës.</td></tr>
<tr><td colspan="2">iii Aktivitetet kryesore të projektit
• Trajnime për prindërit mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre dhe mënyrat e bashkëpunimit me shkollën.
• Organizimi i forumeve dhe diskutimeve për tema të rëndësishme që lidhen me zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve.
• Hartimi i një kalendari vjetor aktivitetesh që përfshin angazhimin e prindërve në mënyrë të rregullt.</td></tr>
<tr><td colspan="2">c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)
Fuqizim të strukturave të prindërve dhe rritjen e angazhimit të tyre në aktivitetet shkollore, duke përmirësuar partneritetin midis prindërve dhe stafit shkollor. Përfshirja aktive e prindërve do të ndihmojë gjithashtu në krijimin e një kulture të qëndrueshme bashkëpunimi dhe zgjidhjeje të problematikave në shkollë.</td></tr>
<tr><td>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)
Drejtoria e shkollës, Prindërti</td><td>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)</td></tr>
<tr><td>d) Periudha e zbatimit:</td><td>e) Ndjek zbatimin e projektit:</td></tr>
</table>

Nr. 2	**Projekti:** Bashkëpunim me Qendrat Shëndetësore për zhvillimin e aktiviteteve mbi sjelljet e shëndetshme.

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Shkolla bashkëpunon me Qendrat Shëndetësore për organizimin e aktiviteteve me fokus shëndetin.

i. Situata:

Qendrat Shëndetësore hartojnë kalendarin e aktivitetve në shkolla dhe zhvillojnë takime informuese me nxënësit, por këto takime nuk i perfshijnë aktivisht nxënësit në veprimtari për ti aftësuar, prandaj sygjerojmët shtimin e aktiviteteve promovuese të shëndetit, si dhe zhvillimi i fushatave sensibilizuese. **Koordinimi i kalendarit me ZVAP**

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Shërbimi shëndetësor në shkolla ka karakter parandalues. Ai ka për qëllim sigurimin e një zhvillimi normal fizik dhe mendor të fëmijëve të shkollës.

Qëllimi kryesor është bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve për përmirësimin e shërbimit shëndetësor në shkolla, nëpërmjet informimit, edukimit, komunimimit për përfitimin e sjelljeve të shëndetshme tek fëmijët e moshës 6-16 vjeç.

Qendrat Shëndetësore duhet të bashkëpunojë dhe me psikologun/punonjësin social, stafin mësimor, bordin e shkollës dhe komunitetin, për të zhvilluar aktivitete me fokus sjelljet e shëndetshme.

ii Synimi i projektit

Rritja e kapacitetit dhe edukimi i fëmijëve nga stafi i Qendrave Shëndetësore mbi sjelljet e shëndetshme dhe promocionin shëndetësor.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

Organizimi i aktiviteteve me Qendrat Shëndetësore në bazë të kalendarit të shëndetësisë.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Numër të lartë aktivitetesh të zvilluara si dhe përqndje të lartë të fëmijëve që kanë përfituar nga këto aktivitete.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Qendrat Shëndetësore DREJTORI ZVAP	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)

d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

Nr. 3	**Projekti:** Kthimi i shkollave në Shkolla Qendër Komunitare

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Shndërrimi i shkollave ne vendin ku realizohet partneriteti shkollë, familje dhe komunitet me fokus zhvillimin akademik, social, fizik, dhe emocional të fëmijës duke shfrytëzuar të gjitha burimet që ofron familja dhe komuniteti.

i. Situata:

Sistemi jonë arsimor ka nevojë për shkollat komunitare, sepse vëzhgimet e kryera dhe përvoja ka treguar që fëmijet dhe të rinjtë kanë nevojë për më shumë mundësi dhe mbështetje që të kenë sukses në studimet dhe veprimtaritë e tyre brenda dhe jashtë orarit mësimor. Kthimi i shkollave në Qendër Komunitare është në rritje dhe prioritet për ZVAP.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Shkollat, familjet dhe komuniteti sot përballen me një sfidë të përbashkët, që është edukimi cilësor për fëmijët e të rinjtë si dhe mundësi për t'iu përgjigjur nevojave të tyre përtej përgatitjes akademike. Fëmijët duhet të njohin dhe të mbajnë qëndrim për çështjet dhe problematikat sociale të komunitetit. Partneriteti me aktorët e tjerë krijon mundësinë e ngritjes dhe realizimit të projekteve me tematika të përbashkëta duke mundësuar gjetjen e rrugëve për zgjidhjen e tyre dhe aftësuar nxënësit për të kontribuar për komunitetet e tyre.

Shkollat, familja dhe komuniteti punojnë së bashku:

- për të ndërtuar strategji të qëndrueshme për fëmijët, të rinjtë dhe familjet
- për të pasuruar dhe nxitur përmes veprimtarive formale dhe jo formale
- për të siguruar një mjedis që ofron dhe integron shërbime për shkollën, familjen dhe komunitetin.

ii Synimi i projektit

Shkolla si qendër komunitare synon zhvillimin cilësor të shkollës dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rinjve si qytetarë të gatshëm dhe të aftë për të kontribuar në komunitetet e tyre.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

- Shkolla organizon aktivitete që kanë si qëllim forcimin e marrëdhënieve: komunitet-nxënës-mësues.
- Shkolla ndërgjegjëson komunitetin për rëndësinë e respektimit të diversitetit
- Shkolla në bashkëpunim edhe me sektorët e shëndetit publik ofron kurse për këshillim familjar.
- Shkolla ofron shërbime psikologjike, sociale, ligjore në rast nevoje të komunitetit.
- Shkolla përgatit komunitetin për strategjitë e ndërhyrjeve në rastin e emergjencave natyrore.

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Fokusi i shkollave qendër komunitare është të ndihmojë në zhvillimin akademik të fëmijëve dhe te rinjve, angazhimin dhe kontributin qytetar, mbeshtetjen e familjes, shërbimet sociale me fokus sigurinë dhe shëndetin si dhe shërbimet komunitare.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)
d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

Nr. 4	**Projekti:** Pjesmarrja aktive e komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit në aktivitete

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Aktivizim i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në shkolla, duke organizuar veprimtari ndërgjegjësuese me nxënësit, mësuesit dhe prindërit për ruajtjen e shëndetit, sigurisë dhe mirëmbajtjen e ambienteve dhe pajisjeve shkollore.

i Situata:

Përgjegjësitë e komisionit përfshijnë mbikëqyrjen e kushteve të shëndetit, sigurisë dhe mirëmbajtjes, identifikimin e nevojave për riparime dhe shërbime, si dhe hartimin e rregullores për këto çështje. Kështu, nga 16 shkolla të cilat plotësuan BAS në Dimal, 14 janë shprehur se higjenizojnë mjediset e përbashkëta duke bërë që ambientet e shkollave të jenë të pastra dhe të sigurta.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Aktivizimi i komisionit për të përmbushur përgjegjësitë dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e shëndetit, sigurisë dhe mirëmbajtjes në mjediset shkollore.

Përgjegjësitë e Komisionit të shëndetit janë:

- Mbikëqyr rregullisht në IA kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së fëmijëve dhe punonjësve, si dhe mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve.
- Identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit.
- Përcakton nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve.
- Propozon procedurat ditore dhe javore të higjienës, pastërtisë dhe mirëmbajtjes së IA-së, të cilat miratohen nga drejtori i institucionit.
- Drejton hartimin e rregullores së shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit.

ii Synimi i projektit

- Sigurimi i funksionalitetit të Komisionit të Shëndetit në përmbushjen e detyrave të tij.
- Pjesëmarrja aktive e komisionit në organizimin e aktiviteteve me nxënësit dhe komunitetin për promovimin e shëndetit dhe sigurisë.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

- Seanca edukative me nxënësit mbi higjienën, sigurinë dhe mirëmbajtjen e ambienteve shkollore.
- Aktivitetet e përbashkëta me bordet e prindërve dhe Qendrat Shëndetësore për promovimin e sjelljeve të shëndetshme.
- Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve të reja për higjienën, mirëmbajtjen dhe sigurinë në shkolla, me miratimin e drejtorisë së institucionit.

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirja e nxënësve në veprimtari edukative mbi shëndetin dhe sigurinë, përmirësimi i kushteve të higjienës dhe mirëmbajtjes në shkollë, dhe funksionimi efektiv i Komisionit të Shëndetit për të siguruar një mjedis shkollor të sigurt dhe të mirëmbajtur.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Anëtarët e Komisionit të shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes.	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)
d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

2.7 Stafi i shkollës

Standardet profesionale të mësuesit janë pohime të cilat harmonizojnë njohuritë dhe të kuptuarin profesional, aftësitë profesionale, si dhe qëndrimet e vlerat profesionale të mësuesit.
Më poshtë janë përmendur 7 standardet të cilat lidhen me angazhimin, interesin dhe përfshirjen e mësuesit në veprimtari trajnuese dhe kualifikuese; me krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës ku secili ndihet i mirëpritur dhe i mirëseardhur; me krijimin e një klime pozitive dhe me përdorimin e teknikave të disiplinimit pozitiv ku fëmijët pranojnë dhe respektojnë njëri-tjetrin; me interesimin e mësuesit për t'u përditësuar me metodologjitë ndërvepruese të mësimdhënies me qëllim zbatimin cilësor të kërkesave të reja kurrikulare; si dhe me krijimin e një atmosfere bashkëpunuese dhe efektive në shkollë ndërmjet drejtuesve, stafit pedagogjik, prindërve dhe përfaqësuesve të komunitetit.
Standardi 1. Angazhimi i mësuesit në zhvillimin e tij profesional
Standardi 2. Zotërimi i përmbajtjes së dokumentacionit kurrikular
Standardi 3. Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës
Standardi 4. Pranimi dhe respektimi i diversitetit
Standardi 5. Përditësimi i metodologjive të mësimdhënies
Standardi 6. Njohja dhe zbatimi i metodave të vlerësimit
Standardi 7. Zbatimi i kodit të etikës

- Shkolla i ofron mësuasve trajnime dhe rritje të kompetencave profesionale në lidhje me promovimin e shëndetit dhe mirëqenies
- Shkolla ka burime të mjaftueshme për të oftuar materiale të përditësuara në lidhje me promocionin e shëndetit dhe mirëqenies
- Shkolla krijon një balancë midis punës dhe jetës private, siguron një ngarkesë pune të përballueshme dhe i ofron mundësi stafit për të diskutuar probleme të ndryshme
- Mësuesve të rinj u ofrohen trajnime për rritjen e tyre profesionale në drejtim të promocionit të shëndetit dhe mirëqenies
- Përballimi i mungesave të personelit dhe ri-integrimi i stafit mësimor
- Shkolla mbështet stafin në arritjen dhe mbajtjen e një mënyre jetese të shëndetshme

2.7.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor: Rritja e njohurive dhe aftësive të mësuesve për të promovuar sjellje të shëndetshme te nxënësit e moshës 6-16 vjeç.

2.7.2 Nën-Objektiva

- **Nën-Objektivi 1:** Ofrimi i trajnimeve për mësuesit mbi sjelljet e shëndetshme në shkollë.
- **Nën-Objektivi 2:** Ofrimi i trajnimeve për stafin shëndetësor (mjekë/infermier) mbi sjelljet e shëndetshme në shkollë.
- **Nën-Objektivi 3:** Riorganizimi i burimeve njerëzore aktuale, duke patur një qasje sa më gjithëpërfshirëse.

2.7.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	**Fakt 2024-2025**	**Plan 2025-2026**
Përqindja e mësuesve që janë trajnuar në platformën e-Learning (Shkollat për Shëndetin).		
Përqindja e stafit shëndetësor që janë trajnuar për promovimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.		
Përqindja e trajnimeve psikologë, punonjës social në shkollë.		
Numri i mjekë/infermierë në shkollë për numër nxënësish.		
Numri i oficerë sigurie në shkollë për numër nxënësish.		
Numri i mësuesve ndihmës për numër fëmijësh me aftësi të kufizuara në shkollë.		

2.7.4 Lista e veprimeve

Nr.	**Nën-objektivi**	**Veprimi**	**Përgjegjës**
1.	Ofrimi i trajnimeve për mësuesit mbi sjelljet e shëndetshme në shkollë.	Regjistrimi i mësuesve në platformën e-Learning për të zhvilluar trajnime online, si edhe zhvillimi i trajnimeve fizike.	Drejtori i IA ZVAP Projekti "Shkollat për Shëndetin"
2.	Ofrimi i trajnimeve për stafin shëndetësor mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.	Zhvillimi i trajnimeve online ose fizik me stafin shëndetësor të Qendrave Shëndetësore, për të promovuar sjelljet e shëndetshme te nxënësit e moshës 6-16 vjeç.	Drejtori i IA Projekti "Shkollat për Shëndetin"
3.	Riorganizimi i burimeve njerëzore aktuale, duke patur një qasje sa më gjithëpërfshirëse.	Mbulimi me aktivitete të promocionit shëndetësor në shkollat e terriorit (mjekët/infermierët rakordojnë punën duke i ofruar shërbim një numri të caktuar shkollash, pranë njëra tjetrës, kur ato kanë nevojë).	ZVAP Qendrat Shëndetësore Drejori i IA
		Mbulimi me shërbim psiko-social në shkollat e terriorit (punonjësit social/psikologët rakordojnë punën duke i ofruar shërbim një numri të caktuar shkollash, pranë njëra tjetrës, kur ato kanë nevojë).	ZVAP Drejori i IA

2.7.5 Lista e projekteve

<table>
<tr><td>Nr. 1</td><td colspan="2">Projekti: Zhvillimi i trajnimeve online në platformën e-Learning</td></tr>
<tr><td colspan="3">a) Përshkrim i shkurtër i projektit:
Në kuadër të Projektit Shkollat për Shëndetin është krijuar një platformë eletronike, përmes të cilës mësuesit mund të ndjekin trajnime online. Mësuesit regjistrohen në platformën e-Learning dhe zhvillojnë module trajnimi.</td></tr>
<tr><td colspan="3">i Situata:
Sipas udhëzimit Nr.16 datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm professional të punonjësve arsimorë” duhet që:
• Punonjësit arsimorë kanë detyrimin të trajnohen të paktën 3 ditë në vit. 3 ditë trajnimi nënkuptojnë 10 kredite nga aktivitetet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional në vit.
Jo të gjithë mësuesit arrijnë të plotësojnë normën e 10 kredite në vit.</td></tr>
<tr><td colspan="3">b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim</td></tr>
<tr><td colspan="3">Platforma e-Learning është krijuar pë ti ardhur në ndihmë stafit mësimor, që të kenë mundësi të zhvillojnë trajnime online në çdo kohë.
Momentalisht në të janë 5 module trajnimi:
• Rëndësia e të ushqyerit shëndetshëm në kurrikulën shkollore të grupmoshës 6-16 vjeç.
• Rëndësia e aktiviteti fizik dhe shëndeti te nxënësit e moshës 6-16 vjeç, për të promovuar një stil jetese të shëndetshme.
• Promovimi i rëndësisë të shëndetit mendor te nxënësit e moshës 6-16 vjeç.
• Edukimi seksual gjithëpërfshirës.
• Higjiena personale, parandalimi i sëmundjeve infektive te nxënësit e moshës 6-16 vjeç dhe mbrojtja e mjedisit.</td></tr>
<tr><td colspan="3">ii Synimi i projektit
Synimi i trajnimeve online është përditësimi i njohurive dhe zhvillimi i kompetencave të stafit mësimor mbi sjelljet e shëndetshme, në mënyrë që t’ju sigurojë të gjithë nxënësve shërbim arsimor cilësor.</td></tr>
<tr><td colspan="3">iii Aktivitetet kryesore të projektit
Trajnimi i mësuesve se si të aksesojnë platformën e-Learning online, si të regjistrohen në të dhe si të zhvillojnë modulin e trajnimit.</td></tr>
<tr><td colspan="3">c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)
Të gjithë mësuesit të jenë regjistruar në platformën e-Learning për të ndjekur trajnime online.</td></tr>
<tr><td>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)

Drejtori i IA dhe mësuesit</td><td colspan="2">Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)

Projekti “Shkollat për Shëndetin”</td></tr>
<tr><td>d) Periudha e zbatimit:</td><td colspan="2">e) Ndjek zbatimin e projektit:</td></tr>
</table>

Nr. 2	**Projekti:** Zhvillimi i trajnimeve online ose fizikisht me stafin shëndetësor të shkollës, për promovimin e sjelljeve të shëndetshme.

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:
Organizimi i trajnimeve për stafin shëndetësor (mjek, infermier, dentist) në shkolla, duke synuar përditësimin e njohurive dhe rritjen e aftësive për promovimin e sjelljeve të shëndetshme tek nxënësit.

i. Situata:
Stafi shëndetësor në shkolla aktualisht nuk ndjek trajnime të rregullta për promovimin e sjelljeve të shëndetshme, duke ndikuar në efektivitetin e edukimit shëndetësor në shkollë. Kjo krijon një nevojë për ngritjen e kapaciteteve të tyre në këtë drejtim.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Trajtimi i temave të promovimit shëndetësor në shkollë kërkon qasje të specializuar për transmetimin efektiv të mesazheve në grupmoshat e reja. Trajnimet do të aftësojnë stafin shëndetësor për të menaxhuar temat mbi sjelljet e shëndetshme dhe për të ndihmuar mësuesit që t'i integrojnë këto tema në programet mësimore.

ii Synimi i projektit
Trajnimet kanë për qëllim përditësimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave të stafit shëndetësor për të nxitur sjelljet e shëndetshme tek nxënësit dhe për të përmirësuar edukimin shëndetësor në shkollë.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

- Organizimi i trajnimeve online ose fizikisht për të gjithë stafin shëndetësor të shkollës mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme.
- Përfshirja e stafit shëndetësor në bashkëpunime me mësuesit për integrimin e temave shëndetësore në kurrikulë.

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)
Të gjithë pjesëtarët e stafit shëndetësor në shkollë të jenë trajnuar dhe të aftë për të promovuar sjelljet e shëndetshme në shkollë, duke përmirësuar cilësinë e edukimit shëndetësor dhe ndikimin e tij tek nxënësit.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Drejtori i IA dhe stafi shëndetësor Qendrat Shëndetësore	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj) Projekti "Shkollat për Shëndetin"
d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

Nr. 3	**Projekti:** Riorganizimi i burimeve njerëzore aktuale, duke patur një qasje sa më gjithëpërfshirëse

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Shfrytëzimi më efektiv i burimeve njerëzore aktuale nëpërmjet organizimit të përshtatshëm, ku stafi (mjekë, infermierë, psikologë) të jetë i shpërndarë në mënyrë të drejtë dhe i gatshëm për të shërbyer në shkollat që kanë më shumë nevojë, përfshirë ato në zona rurale.

i Situata

Mungesa e stafit shëndetësor dhe psiko social në shkolla, veçanërisht në zonat rurale, e bën të nevojshme riorganizimin e burimeve për t'i shërbyer sa më mirë shkollave. Aktualisht, shkollat në zona urbane kanë më shumë akses në staf shëndetësor dhe psiko social, ndërsa ato në zona rurale vuajnë nga mungesa e mbulimit.

Aktualisht, 16 shkollat në Dimal që kanë plotësuar BAS janë shprehur se nuk kanë asnjë mjek dhe vetëm nje shkollë është shprehur se ka një dentist të punësuar në strukturën e tyre.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Rishpërndarja e burimeve njerëzore me një sistem të organizuar do të ndihmojë në mbulimin e shkollave në zonat me problematika. Rakordimi i orarit dhe shpërndarja sipas nevojave do të sigurojë që çdo shkollë të ketë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore, duke garantuar asistencë në raste emergjencash apo problematikash shëndetësore.

ii Synimi i projektit

Të sigurohet akses i barabartë në shërbime shëndetësore për të gjitha shkollat, duke lejuar që stafi shëndetësor të mbulojë deri në 4 shkolla afër njëra-tjetrës dhe të jetë i gatshëm të ndërhyjë në çdo rast emergjence.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

- Riorganizimi i stafit shëndetësor dhe psiko social për të mbuluar shkollat në zona urbane dhe rurale.
- Hartimi i një orari fleksibël që lejon stafin të vizitojë deri në 2 shkolla në ditë dhe të ndërhyjë në rast emergjencash.
- Shpërndarja e drejtë e burimeve njerëzore bazuar në nevojat specifike të shkollave.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Një riorganizim efikas i burimeve njerëzore që garanton akses të barabartë në shërbime shëndetësore për të gjitha shkollat dhe përdorimin sa më të efektshëm të stafit të disponueshëm.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Stafi shëndetësor dhe psiko social, Drejtori i IA, ZVAP	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)
d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

Nr. 4	**Projekti:** Shtimi i Oficerëve të Sigurisë në Shkolla

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Shtimi i oficerëve të sigurisë në shkolla, ka si qëllim të rrisë nivelin e sigurisë në shkolla, të cilët do të kontribuojnë në mbrojtjen e nxënësve, mësuesve dhe stafit të shkollës. Shtimi i këtyre oficerëve synon të krijojë një mjedis më të sigurt dhe të mbrojë shkollat nga kërcënime të mundshme, si dhe të rrisë ndjenjën e sigurisë për komunitetin shkollor.

ii. Situata:

Aktualisht, disa shkolla përballen me mungesë të mjaftueshme të masave të sigurisë, duke krijuar mundësi për incidente të papritura që mund të dëmtojnë sigurinë e nxënësve dhe stafit shkollor. Rritja e dhunës shkollore, aktet vandale dhe kërcënimet e tjera për sigurinë janë bërë shqetësime të vazhdueshme. Disa shkolla kanë tashmë oficerë sigurie, por numri i tyre është i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjitha institucionet edukative.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Siguria e shkollave është një çështje që kërkon një vëmendje të vazhdueshme, duke marrë parasysh që mjedisi edukativ duhet të jetë i sigurt për zhvillimin e nxënësve. Mungesa e oficerëve të sigurisë në shumë shkolla krijon mundësi për aktet kriminale dhe sjellje të dhunshme që ndikojnë në mirëqenien e nxënësve dhe stafit. Kjo është një situatë që kërkon ndërhyrje të menjëhershme dhe të qëndrueshme për të siguruar një mjedis edukativ të sigurt për të gjithë.

ii Synimi i projektit

Synimi kryesor i këtij projekti është të sigurohet një mjedis shkollor i sigurt dhe i mbrojtur për nxënësit, mësuesit dhe stafin e shkollës. Përmes shtimit të oficerëve të sigurisë në shkolla, projekti synon parandalimin e incidenteve të dhunshme dhe të sigurojë një atmosferë të qetë dhe të përqendruar në arsimim.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

- Vlerësimi i situatës së sigurisë në shkolla: Analizimi i shkollave që kanë nevojë për shtimin e oficerëve të sigurisë, bazuar në rrezikun dhe historikun e incidenteve.
- Rekrutimi dhe trajnim i oficerëve të sigurisë: Procesi i rekrutimit dhe trajnimi i oficerëve të sigurisë për të siguruar se ata janë të përgatitur për të menaxhuar situatat në shkolla.
- Vlerësimi i performancës së oficerëve të sigurisë dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e sigurisë shkollore.

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

- Rritja e sigurisë në shkolla.
- Reduktimi i incidenteve të dhunshme dhe kriminale.
- Përmirësimi i mjedisit të të mësuarit.
- Rritja e besimit të komunitetit në shkolla.
- Shkollat do të kenë një imazh më të mirë dhe do të forcojnë lidhjet me prindërit dhe komunitetin.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Oficerët e Sigurisë Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)

d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

Nr. 5	Projekti: **Shtimi i Psikologëve dhe Punonjësve Social në Shkolla**

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Shtimi i Psikologëve apo Punonjësve Social ka si qëllim të ofrojë mbështetje psikologjike dhe sociale për nxënësit, mësuesit dhe stafin shkollor, duke shtuar numrin e psikologëve dhe punonjësve social në shkolla. Këta profesionistë do të ofrojnë mbështetje për nxënësit që përballen me vështirësi emocionale, sociale dhe psikologjike, duke kontribuar në përmirësimin e mirëqenies dhe zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve dhe të rinjve në mjedisin shkollor.

i Situata:

Në shumë shkolla aktualisht nuk ka mjaftueshëm mbështetje psikologjike dhe sociale për nxënësit, çka krijon mundësi për probleme të ndryshme emocionale dhe sociale që mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre. Çështjet si stresi, ankthi, depresioni, dhuna familjare, janë duke u bërë më të shpeshta, dhe shumë nxënës nuk kanë mundësi të aksesojnë ndihmën që u nevojitet.

Lidhur me numrin e Psikologëve dhe Punonjësve Social në shkolla, në Dimal, nga 16 shkolla të cilat plotësuan BAS, rezulton se vetëm një shkollë ka shprehur se ka një Punonjës Social dhe 11 shkolla kanë shprehur se kanë nga një Psikolog.

b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Mungesa e mbështetjes psikologjike dhe sociale në shkolla ka krijuar një hendek në mbrojtjen dhe zhvillimin e nxënësve, sidomos ata që përballen me vështirësi të ndjeshme emocionale, psikologjike dhe sociale. Kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë në performancën shkollore, si dhe mund të çojë në përkeqësimin e shëndetit mendor të nxënësve dhe krijimin e një klime të pasigurt. Shtimi i psikologëve/punonjësve social duhet bërë bazuar në *Urdhërin 461 dt 27/07/2022 Për një ndryshim në Urdhërin 313 datë 20/10/2020 Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimi, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko social i ndryshuar*.

ii Synimi i projektit

Shtimi i psikologëve dhe punonjësve social, është të sigurojë mbështetje psikologjike dhe sociale për nxënësit dhe stafin shkollor përmes shtimit të psikologëve dhe punonjësve social. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi edukativ më të shëndetshëm dhe të mbrojtur, ku nxënësit mund të përballen me sfidat e tyre emocionale dhe sociale dhe të zhvillohen në një mënyrë pozitive.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

- Vlerësimi i nevojave për mbështetje psikologjike dhe sociale
- Rekrutimi dhe trajnimi i psikologëve dhe punonjësve social
- Përfshirja e psikologëve dhe punonjësve social në shkolla

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

- Rritja e mbështetjes psikologjike dhe sociale në shkolla:
- Përmirësimi i shëndetit mendor të nxënësve:
- Rritja e ndjenjës së sigurisë dhe mirëqenies në shkolla:

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Psikologët/Punonjësit Social Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)

d) Periudha e zbatimit:	**e) Ndjek zbatimin e projektit:**

2.8 Menaxhimi i procesit të promocionit të shëndetit dhe mirëqenies nga shkolla

- Planet afatmesme të shkollës lidhur me promocionin e shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve
- Planet vjetore të shkollës lidhur me promocionin e shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve
- Drejtoria e shkollës monitoron shërbimin psiko-social
- Drejtoria e shkollës monitoron shërbimin shëndetësor
- Drejtoria e shkollës monitoron shërbimin e pastrimit dhe higjienës
- Drejtoria e shkollës bashkëpunon me institucionet e edukimit, shëndetësisë, dhe qeverisjes lokale
- Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit
- Pjesëmarrja e Bordit të Shkollës, Këshillit të Prindërve, dhe Qeverisë së Nxënësve
- Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, dhe Komisioni i Disiplinës punojnë aktivisht për të zgjidhur ankesat e nxënësve në lidhje me shëndetin, me mirëqenien dhe me veprimtaritë fizike

2.8.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor: Monitorimi dhe dokumentimi/raportimi periodik i shërbimeve të promocionit shëndetësor në shkollë nga drejtori i institucionit arsimor tek ZVA.

2.8.2 Nën-Objektiva

- **Nën-Objektivi 1:** Raportimi i çdo veprimtarie që zhvillon shërbimi psiko-social, shërbimi shëndetësor, shërbimi i pastrimit dhe higjenës, Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, Bordi i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Qeveria e Nxënësve dhe Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, dhe Komisioni i Disiplinës.

2.8.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	**Fakt 2024-2025**	**Plan 2025-2026**
Përqindja e shkollave që raportojnë periodikisht për shërbimet e promocionit shëndetësor në shkollë, tek ZVA.		
Përqindja e shkollave që raportojnë periodikisht për shërbimin psiko-social në shkollë, tek ZVA.		
Përqindja e shkollave që raportojnë periodikisht për shërbimin e pastrimit dhe higjenës në shkollë, tek ZVA.		

2.8.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Raportimi periodikm i monitorimit të shërbimeve: • psiko-social, • shëndetësor, • i pastrimit dhe higjenës, • Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, • Bordi i Shkollës, • Këshillit të Prindërve, • Qeverisë së Nxënësve • Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, dhe Komisioni i Disiplinës	- Të dokumentohet realizimi i aktiviteteve mes institucionit arsimor me OJF. - Të dokumentohet monitorimi i të gjitha shërbimeve të promocionit shëndetësor nga drejtori. - Të raportohet monitorimi i punës dhe i aktiviteteve që zhvillojnë bordi i shkollës dhe komisionet e ngritura.	Drejtori i IA

2.8.5 Lista e projekteve

<table>
<tr><td>Nr. 1</td><td>Projekti: Raportimi në mënyrë periodike i aktiviteteve të monitoruara nga drejtuesi i institucionit arsimor.</td></tr>
<tr><td colspan="2">a) Përshkrim i shkurtër i projektit:
Hartimi i një dokumenti të thjeshtë dhe standard për të raportuar në mënyrë periodike çdo aktivitet dhe shërbim në shkollë nga drejtori i institucionit arsimor.</td></tr>
<tr><td colspan="2">i Situata
Sipas Urdhrit Nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”, raportimi periodik është një detyrim për drejtuesit e shkollave.</td></tr>
<tr><td colspan="2">b) Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Në praktikë, procesi i raportimit të aktiviteteve dhe shërbimeve nga drejtuesit e shkollave shpesh është i pastrukturuar dhe i paplotë. Kjo mund të ndikojë në:
• Monitorimin joefektiv të aktiviteteve dhe shërbimeve.
• Pamundësinë për të ndjekur me saktësi progresin e planifikimeve dhe intervenimeve.</td></tr>
<tr><td colspan="2">ii Synimi i projektit
Krijimi i një mekanizmi të standardizuar për raportim, duke përmirësuar cilësinë dhe frekuencën e raportimeve në përputhje me rregulloret dhe detyrimet ligjore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">iii Aktivitetet kryesore të projektit
• Hartimi i formatit të standardizuar të dokumentit për raportimin periodik.
• Dërgimi i raportimeve periodike nga drejtori i shkollës drejt Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP).
• Vlerësimi i progresit përmes analizës së raportimeve periodike.</td></tr>
<tr><td colspan="2">c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)
• Përmirësim i strukturës dhe përmbajtjes së raporteve.
• Lehtësim i ndjekjes së aktiviteteve dhe shërbimeve nga institucionet e arsimit parauniversitar.
• Drejtuesit e shkollave do të jenë më të përgatitur për të përmbushur detyrimet e tyre ligjore dhe operacionale.</td></tr>
<tr><td>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)

Drejtuesi i IA</td><td>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)</td></tr>
<tr><td>d) Periudha e zbatimit:</td><td>e) Ndjek zbatimin e projektit:</td></tr>
</table>

Aneks A- Kalendari i aktiviteteve

Kalendari i aktiviteteve është ndërtuar mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) Udhëzim i përbashkët Nr.13, datë 10.07.2024, "Për Vitin Shkollor 2024–2025 Në Sistemin Arsimor Parauniversitar". Në kalendarin që ka hartuar MAS janë propozuar disa aktivitete të reja që kanë në fokus trajtimin e temave mbi "sjelljet e shëndetshme". Projekti "Shkollat për Shëndetin", gjatë katër viteve aktivitetet e propozuara i ka validuar dhe përmirësuar bazuar në sugjerimet e marra nga mësuesit.

Legjenda

- Me ngjyrë jeshile të errët janë aktivitetet me fokus shëndetin të propozuara nga Projekti "Shkollat për Shëndetin"
- Me ngjyrë gri janë aktivitete të cilat kanë lidhje dhe me sjelljet e shëndetshme të propozuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- Me ngjyrë të bardhë janë aktivitete të planifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të cilat nuk janë të dedikuara për sjelljet e shëndetshme.

Nr.	Veprimtaria	Aktivitete	Qëllimi	Personat përgjegjës	Afati
1.	Higjiena personale dhe parandalimi i sëmundjeve infektive.	- Organizimi i seancave për pastrimin e mjediseve përreth shkollës, mjediseve tjera komunitare (parqe, etj.).	- Përshkrimi i aspekteve të përgjithshme të higjienës së përditshme. - Masat që duhen marrë për higjienën e duhur. - Shkaqet dhe simptomat e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera infektive. - Rëndësia e mbajtjes së higjienës personale.	-Shërbimi shëndetësor -Shërbimi psiko-social -Mësuesit kujdestarë - Koordinatori i shëndetit	20 Shtator
2.	Dita Evropiane e gjuhëve të huaja	- **Shkruaje dhe përktheje**: Lojë ku një frazë përkthehet në disa gjuhë dhe rikthehet në origjinal për të parë ndryshimet.	- Rëndësia e të mësuarit të gjuhëve të huaja për të rritur të kuptuarit ndërkulturor. - Promovimi i larmishmërisë gjuhësore dhe kulturore të Evropës.	Mësuesit e ekipit lëndor të gjuhëve të huaja	26 Shtator

		- Organizimi i këndeve për secilën gjuhë, ku nxënësit mund të mësojnë rreth ushqimit, muzikës dhe zakoneve të asaj gjuhe.			
3.	Java evropiane e sportit	- Organizimi i kompeticioneve sportive dhe garave/ konkurseve midis klasave dhe me gjerë.	- Promovimi i vlerave të veprimtarisë fizike në rritjen e mirëqenies fizike, emocionale e mendore të nxënësve. - Rëndësia e aktivitetit fizik dhe shëndetit te nxënësit, duke i orientuar drejt një stili jetese të shëndetshme.	Mësuesit e edukimit fizik Koordinatori i shëndetit	Java e fundit e shtatorit
4.	Sensibilizimi për shëndetin e zemrës	- Prezantim mbi faktorët që ndikojnë në shëndetin e zemrës, si dieta, ushtrimet, gjumi dhe shmangia e duhanit. - Organizimi i një ecje ose vrapimi simbolik për zemrën e shëndetshme - Mësimi i nxënsve mbi teknikat e thjeshta të frymëmarrjes dhe relaksimit për të ulur stresin	- Të rrisin ndërgjegjësimin për faktorët që kontribuojnë në shëndetin e zemrës, si dieta, aktiviteti fizik dhe shmangia e zakoneve të dëmshme. - Të promovojnë zakone të shëndetshme që ndihmojnë në parandalimin e sëmundjeve të zemrës që në moshë të hershme.	Qendrat Shëndetësore Shkolla	29 Shtator
5.	Kujdesi për një ushqyerje të shëndetëshme dhe obeziteti	- Diskutimi mbi rëndësinë e një diete të balancuar dhe rolin e grupeve ushqimore: proteinat, karbohidratet, yndyrnat, vitaminat dhe mineralet. - Organizimi i një diskurimi me një dietolog mbi zgjedhjet e shëndetshme.	Rritja e ndërgjegjësimit për ushqyerjen e shëndetshme dhe parandalimin e obezitetit. Nxitja e zakoneve pozitive dhe një qasjeje të balancuar ndaj ushqimit që nga mosha e hershme.	Qendrat Shëndetësore Shkolla	Shtator
6.	Kujdesi ndaj shëndetit të gojës dhe ndihmës së shpejtë	- Diskutoni rëndësinë e higjienës orale dhe demonstrimi i teknikave të duhura të larjes së dhëmbëve nga një dentist.	Të edukohen nxënësit për rëndësinë e kujdesit oral dhe shëndetit të gojës për një mirëqenie të përgjithshme.	Qendrat Shëndetësore Shkolla	Shtator

		- Diskutim çfarë është ndihma e parë dhe pse është e rëndësishme. - Prezantim i hapave bazë për trajtimin e plagëve të lehta, gjakderdhjes, mavijosjeve apo djegieve.	Të aftësohen për t'iu përgjigjur situatave të thjeshta emergjente, duke rritur vetëbesimin dhe sigurinë personale.		
7.	Dita botërore e shëndetit mendor	- Zhvillimi i takimeve me ekspert të shëndetësisë (psikologë, sociologë dhe koordinatorët e shëndetit) për të ndarë me nxënësit informacione rreth shëndetit mendor.	- Rëndësia e menaxhimit të stresit te adoleshentët. - Organizimi i studimit me anë të pyetësorëve për të identifikuar shkaqet e stresit tek adoleshentët. - Takim me komunitetin për të shpjeguar simptomat emocionale dhe fizike të nxënësve që lidhen me stresin.	Shërbimi shëndetësor Shërbimi psiko-social Mësuesit e qytetarisë dhe biologjisë Koordinatori i shëndetit	10 Tetor
8.	Dita botërore e urisë	- Organizimi i nxënësve për të mbledhur ushqime dhe shpërndarja e tyre në familjet në nevojë.	- Të ndihmojmë njerëzit në nevojë. - Sensibilizimi i nxënësve për shpërndarjen e ndihmave për familjet në nevojë	Drejtoria e shkollës Mësuesit kujdestarë Qeveria e nxënësve	17 Tetor
9.	Muaj i ndërgjegjësimit për parandalimin e kancerit të gjirit.	Aktivitete ndërgjegjësusese nga Qendrat Shëndetësore me nxënësit për ti informuar rreth kancerit të gjirit dhe rëndësinë e parandalimit të tij. Nxënësit krijojnë postera, vizatime, ose kolazhe me mesazhe mbështetëse dhe informuese për ndërgjegjësimin.	- Të edukohen nxënësit për rëndësinë e parandalimit dhe ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit.	Qendrat Shëndetësore Shkolla	Tetor

10.	Të ushqyerit e shëndetshëm	Organizimi i panaireve ushqimore, tregje me ushqime të shëndetshme me pjesëmarrjen e prindërve, nxënësve, pushtetit vendor dhe komunitetit në tërësi.	- Rëndësia e të ushqyerit shëndetshëm. - Dallimi i ushqimeve të shëndetshme ndaj atyre të pashëndetshme. - Organizimi i aktiviteteve me temë: "Menu e shëndetshme"	Shërbimi shëndetësor Mësuesit e qytetarisë dhe biologjisë Koordinatori i shëndetit	26 Tetor
11.	Dita Botërore e Gjuhës Rome	**Organizim i materialeve nga nxënësit për** historinë, kulturën dhe gjuhën Rome. Mund të përfshihen tema të ndryshme si muzika, vallëzimi, artizanatet dhe zakonet.	- Aktivitete do të rrisin respektin dhe mirëkuptimin për diversitetin kulturor në shkollë	Mësuesit e shkollës	5 Nëntor
12.	Dita Ndërkombëtare e të drejtave të fëmijëve	Organizimi i diskutimeve mbi "Të drejtën e shëndetit dhe të shërbimeve shëndetësore".	- Njohja e Konventës për të drejtat e fëmijëve dhe respekti për të drejtat e të gjithëve.	Mësuesit kujdestarë Qeveria e nxënësve Shërbimi psiko-social	20 Nëntor
13.	Dita e Luftës kundër bullizmit	- Organizimi i trajnimeve nga shërbimi psiko-social rreth formave të bullizmit dhe si ta parandalojmë. Njohja me simtomat që shfaq një fëmijë i bullizuar dhe si duhet të reagojnë nxënësit e tjerë, për ta ndihmuar.	- Efektet negative të bullizmit te fëmijët. - Vlerësimi i formave të ndryshme të shfaqjes së bullizmit. - Realizimi i pyetësorëve me nxënës në shkollë, mbi format e shfaqjes së bullizmit.	Mësuesit kujdestar Shërbimi psiko-social Qeveria e nxënësve.	21 Nëntor
14.	Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe	Prezantime për historinë e alfabetit Panel diskutimi me një mësues ose ekspert që flet për zhvillimin dhe rëndësinë e alfabetit shqip. Ekspozitë në korridoret e shkollës ku nxënësit mund të shohin dhe	- Përforcimi i njohurive dhe dashurisë për gjuhën dhe alfabetin shqip tek nxënësit, duke e bërë Ditën e Alfabetit të Gjuhës Shqipe një përvojë edukative dhe festive në shkollë.	Drejtoria dhe mësuesit e shkollës	22 Nëntor

		mësojnë më shumë rreth alfabetit dhe simbolikës së tij Konkurs për shkrim të bukur Një pjesë teatrale e shkurtër që tregon për Kongresin e Manastirit ose për vështirësitë në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe			
15.	Sensibilizimi për Luftën Kundër Diabetit	- Diskutim në mënyrë të thjeshtë çfarë është diabeti, llojet e tij, dhe faktorët e rrezikut. - Organizoni një lojë ku nxënësit ndajnë ushqimet në kategori si "Të shëndetshme" dhe "Të pashëndetshme". Diskutoni si ndikojnë ato në nivelin e sheqerit në gjak.	- Të rrisin ndërgjegjësimin e nxënësve për diabetin dhe faktorët që ndikojnë në parandalimin e tij. - Të promovojnë zakone të shëndetshme që mund të adoptohen që në moshë të hershme	Qendrat Shëndetësore Shkolla	Nëntor
16.	Ndërgjegjësimi për Trafikun Rrugor	- Diskutoni rregullat bazë të trafikut dhe rëndësinë e respektimit të tyre për sigurinë personale dhe të të tjerëve. - Prezantoni shenjat kryesore të trafikut dhe kuptimin e tyre - Ftoni një polic rrugor ose ekspert të trafikut për të folur mbi sigurinë rrugore dhe për të demonstruar situata reale.	- Të promovojnë sigurinë rrugore si pjesë e jetës së përditshme. - Të zhvillojnë ndërgjegjësimin për rolin e tyre në ruajtjen e sigurisë personale dhe të komunitetit.	Qendrat Shëndetësore Shkolla	Nëntor
17.	Sensibilizimi për Parandalmin e Abuzimit me Fëmijët.	- Prezantimi i shembujve praktikë për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë situatat kur mund të ndihen të kërcënuar ose të pasigurt. - Ftoni psikologë, punonjës socialë ose policë që merren me	- Të edukohen nxënësit për të drejtat e tyre dhe mënyrat për të mbrojtur veten. - Të zhvillojnë vetëbesimin dhe aftësinë për të raportuar situata të pasigurta.	Qendrat Shëndetësore Shkolla	Nëntor

		mbrojtjen e fëmijëve për të folur me nxënësit dhe diskutoni për pasojat e abuzimit dhe rëndësinë e të folurit me një të rritur të besuar.			
18.	Veprimtari me rastin e shpalljes se pavaresise. Kontributi i letersise shqiptare ne pavaresine e Shqiperise	- Organizimi i një ore letrare ku nxënësit recitojnë poezi dhe fragmente nga autorë që kanë kontribuar me veprat e tyre në ndjenjën kombëtare dhe për pavarësinë e Shqipërisë.	- Këto aktivitete synojnë të ndërgjegjësojnë nxënësit për rolin e letërsisë në frymëzimin e pavarësisë dhe të promovojnë vlerat kombëtare.	Mësuesit e shkollës	27 Nëntor
19.	Dita Ndërkombëtare e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar	- Organizimi i nxënësve për të mbledhur tapat e shisheve, dhe dorzimi i tyre në organizata joqeveritare, ku bëhet shkëmbimi i tapave me karroca për fëmijët me aftësi të kufizuar.	- Të barabartë në të drejta por të ndryshëm në nevoja. - Ndërgjegjësimi i nxënësve mbi problematikat me të cilat hasen personat me aftësi të kufizuara.	Shërbimi psiko-social dhe mësuesit ndihmës	3 Dhjetor
20.	Dita e vullnetarizmit	- Zhvillimi i seancave të pastrimit në ambjentet e përbashkëta.	- Ndërgjegjësimi i nxënësve për vullnetarizmin në përgjithësi dhe pastrimin e mjedisit në veçanti.	Mësuesit e shkollës	5 Dhjetor
21.	Dita e Tolerances dhe Mirekuptimit	- Nxënësit krijojnë postera ose pankarta me mesazhe dhe vizatime që promovojnë vlerat e tolerancës dhe mirëkuptimit. - Organizoni një mini-teatër ku nxënësit interpretojnë situata ku përballohen me intolerancë dhe tregojnë zgjidhje të mundshme për të ndërtuar mirëkuptim dhe respekt.	- Edukimi i nxënësve për rëndësinë e tolerancës dhe mirëkuptimit në krijimin e një shoqërie harmonike. - Zhvillimi i aftësive për të pranuar diversitetin dhe për të ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme me të tjerët.	Mësuesit e shkollës	9 Dhjetor

22.	Dita e të drejtave të njeriut UNESCO			Nxënësit	10 Dhjetor
23.	Dita Ndërkombëtare e Emigrantëve	- Diskutim mbi emigracionin në historinë e Shqipërisë	- Ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e diversitetit kulturor dhe solidaritet për përvojat e emigrantëve, duke krijuar një atmosferë të përfshirjes dhe respektit.	Mësuesit e shkollës	18 Dhjetor
24.	-Kampionati Kombëtar i Shahut	- Kampionati do të zhvillohet në dy faza ku gjatë dhjetorit do zhvillohet faza e pare.	-	Nxënësit	Dhjetor
25.	Sensibilizimi për të drejtat dhe barazinë në shëndet	- Nxënësit diskutojnë konceptin e të drejtave shëndetësore dhe rëndësinë e barazisë në aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore. - Nxënësit mësojnë për institucionet që mbrojnë të drejtat shëndetësore në vend dhe diskutojnë për mënyrat se si të kërkojnë ndihmë ose informacion në rast nevoje.	- Të ndërgjegjësojnë nxënësit për rëndësinë e të drejtave shëndetësore dhe barazisë në aksesin ndaj kujdesit shëndetësor. - Të frymëzojnë veprime konkrete për një shoqëri më të drejtë dhe të shëndetshme.	Qendrat Shëndetësore Shkolla	Dhjetor
26.	Sensibilizimi për parandalimin e IST/HIV/AIDS	- Nxënësit krijojnë postera me mesazhe të rëndësishme për parandalimin e IST/HIV/AIDS. - Organizimi i një fushate sensibilizuese për të promovuar tolerancën dhe mbështetje për ata që jetojnë me HIV. Nxënësit krijojnë mesazhe për të luftuar	- Të informohen nxënësit mbi parandalimin e IST dhe HIV/AIDS dhe mënyrat e mbrojtjes. - Të inkurajohen ata të marrin përgjegjësi për shëndetin e tyre seksual dhe të krijojnë një mjedis pa diskriminim për ata që janë të prekur nga HIV/AIDS.	Qendrat Shëndetësore Shkolla	Dhjetor

		stigma dhe diskriminimin ndaj individëve që kanë HIV.	- Të nxisin edukimin e nxënësve për rëndësinë e testimit dhe mbrojtjes nga IST dhe HIV.		
27.	**Punëtori me prindërit:** Diskutim mbi shëndetin e fëmijëve dhe zakonet e mira që duhen ndjekur në shtëpi.	- Diskutim mbi rëndësinë e aktivitetit fizik për fëmijët dhe prindërit duke ndarë ide dhe këshilla mbi mënyrat për të integruar aktivitetin fizik në jetën e përditshme të familjes. - Diskutim me prindërit për rëndësinë e higjenës personale të fëmijëve dhe mënyrat për t'i mësuar ata të mbajnë higjienën e duhur. - Nxënësit dhe prindërit do të krijojnë një listë të ushqimeve të shëndetshme që mund të konsumohen çdo ditë.	- Të forcohet bashkëpunimi ndërmjet prindërve dhe mësuesve për të siguruar një shëndet të mirë për nxënësit. - Të inkurajohen ata të krijojnë një ambient të shëndetshëm në shtëpi që mbështet zhvillimin e fëmijëve fizikisht, emocionalisht dhe psikologjikisht.	Komuniteti, prindërit dhe shkolla	Dhjetor
28.	Festojmë festat e fund vitit	- Nxënësit përgatitin një koncert për të festuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri.	- Të gjithë bashkë për të mbyllur një vit dhe për të pritur me entuziazëm vitin e ri.	Drejtoria dhe mësuesit e shkollës	23 Dhjetor
29.	Edukimi seksual gjithëpërfshirës	- Organizimi i takimeve me shërbimin shëndetësor, për të rritur kapacitete mbi edukimin seksual.	- Identifikimi i infeksioneve seksualisht të transmetueshme. - Analizimi i shkaqeve dhe simptomave të infeksioneve seksualisht të transmetueshme. - Rëndësia e edukimit të shëndetit seksual.	Shërbimi shëndetësor Shërbimi psiko-social Mësuesit e biologjisë Koordinatori i shëndetit	10 Janar
30.	Fushatë mbi rëndësinë e	- Prezantim edukativ që shpjegon se si gjumi i mirë ndikon në	- Të ndihmojë nxënësit të kuptojnë rëndësinë e gjumit dhe ndikimin e	Qendrat Shëndetësore	Janar

	gjumit: Materiale edukative dhe diskutime në klasë.	shëndetin fizik dhe mendor të fëmijëve. - Nxënësit krijojnë një listë të faktorëve që ndihmojnë për një gjumë të qetë (mjedisi i errët, i qetë, temperatura e përshtatshme, etj.).	tij në shëndetin e tyre të përgjithshëm dhe performancën akademike. - Të inkurajojnë fëmijët të zhvillojnë zakone të shëndetshme të gjumit dhe të krijojnë një rutinë të duhur. - Të promovojnë një kulturë ndërgjegjësimi dhe edukimi për gjumin e shëndetshëm në shkolla.	Shkolla dhe mesuesit e lendes se biologjise	
31.	Edukim mbi parandalimin e sëmundjeve sezonale: Ore të dedikuara për kujdesin gjatë dimrit.	- Ftohet një mjek ose një specialist i shëndetit për të zhvilluar një orë mësimore në lidhje me kujdesin që duhet të tregojmë gjatë dimrit, si mbrojtja nga sëmundjet e ftohjes dhe gripit, dhe rëndësia e vitaminave dhe ushqimit të shëndetshëm. - Nxënësit organizojnë një fushatë ndërgjegjësimi në shkollë për rëndësinë e parandalimit të sëmundjeve dimërore.	- Të edukohen nxënësit mbi rëndësinë e kujdesit shëndetësor gjatë dimrit për të parandaluar sëmundjet sezonale. - Të krijohen zakone të shëndetshme dhe të qëndrueshme që do të mbrojnë nxënësit nga gripi dhe ftohjet. - Të inkurajohen praktikat e higjienës dhe të krijohet një mjedis i shëndetshëm në shkollë dhe në shtëpi.	Qendrat Shëndetësore Shkolla dhe mesuesit e lendes se biologjise	22 Janar
32.	Dita ndërkombëtare e Edukimit	- Rëndësia e edukimit - Tryeza diskutimi me nxënës të klasave të AMU. - Vizitë në bibliotekën e qytetit ose takim me personalitete të njohura në fushën e edukimit.	- Promovimi i talenteve në art, letëresi, sport, etj.	Drejtoria e shkollës Mësuesit kujdestarë Të ftuar të ndryshëm	24 Janar
33.	Përkujtimi i holokoaustit dhe i krimeve kundër njerëzimit.	- Shikimi i një filmi.	- Roli mbështetës i popullit tonë gjatë luftës së dytë botërore ndaj përndjekjes së hebrenjve. - Gjykimi mbi pasojat e holokaustit.	Mësuesit e historisë Qeveria e nxënësve	27 Janar

34.	**Ditët e sigurisë në internet:** Diskutim mbi ndikimin e teknologjisë në shëndetin mendor.	- Organizimi i një aktiviteti ku shpjegohet ndikimi i teknologjisë në shëndetin mendor, përfshirë përdorimin e mediave sociale, mundësitë dhe rreziqet që lidhen me përdorimin e internetit dhe pajisjeve dixhitale. - Nxënësit mund të ndajnë mendimet e tyre dhe të krijojnë një fletushkë informuese që ndihmon të tjerët të kuptojnë ndikimet negative të mediave sociale dhe si mund të mbrohen nga ato.	- Të edukohen nxënësit mbi ndikimin e teknologjisë në shëndetin mendor dhe si të mbrohen nga efektet negative. - Të inkurajohen zakone të shëndetshme për përdorimin e internetit dhe teknologjisë. - Të krijohet një mjedis mbështetës për të mbrojtur mirëqenien mendore të nxënësve gjatë përdorimit të teknologjisë.	Shkolla	Shkurt
35.	**Ora mësimore për alkoolin dhe duhanin:** Edukim mbi ndikimin e tyre në shëndet.	- Organizimi i një prezantimi edukativ që shpjegon se si alkooli dhe duhani ndikojnë negativisht në trupin e njeriut. Kjo mund të përfshijë dëmet për organet e ndryshme, si mushkëritë, mëlçia, zemra dhe truri. Po ashtu, përmendet edhe lidhja me varësinë dhe rreziqet e konsumit të këtyre substancave në moshë të re. - Nxënësit studiojnë biografitë e personazheve të njohur (aktori, këngëtarë, sportistë) që kanë pësuar nga përdorimi i alkoolit dhe duhanit, si dhe ndikimin që	- Të edukohen nxënësit mbi rreziqet e alkoolit dhe duhanit për shëndetin. - Të promovohen zakone të shëndetshme dhe vendime të informuara për shmangien e përdorimit të alkoolit dhe duhanit. - Të zhvillohen diskutime dhe aktivitete që inkurajojnë nxënësit të qëndrojnë larg këtyre substancave dhe të ndihmojnë në përhapjen e mesazheve pozitive mbi shëndetin.	Mësuesit e biologjisë.	Shkurt

		ka pasur kjo në karrierën dhe shëndetin e tyre.			
36.	Muaji i ndërgjegjësimit për luftën kundër kancerit	- Organizimi i një prezantim për nxënësit dhe mësuesit që shpjegon çfarë është kanceri, faktorët që ndikojnë në zhvillimin e tij dhe rëndësinë e diagnostikimit të hershëm. Duke përdorur video edukative dhe materiale vizuale për ta bërë informacionin më të lehtë për t'u kuptuar. - Krijoni një pemë simbolike në një hapësirë të dukshme të shkollës. Çdo nxënës dhe mësues mund të vendosë një fletë të vogël në pemë ku të shkruajë një mesazh inkurajues ose një fakt mbi parandalimin e kancerit.	- Të rritet ndërgjegjësimi për kancerin dhe mënyrat për parandalimin e tij. - Të inkurajohet një jetë e shëndetshme dhe e balancuar për nxënësit dhe komunitetin. - Të krijohet një atmosferë mbështetjeje dhe solidariteti në shkollë.	Qendrat Shëndetësore Shkollat	Shkurt
37.	Shkolla e gjelbër	Zhvillimi i një konkursi, një fushate sensibiluese, apo lobim për ta shndërruar shkollën në shkollë të gjelbër, p.sh duke mbjellur perime, lule në kopshtin e shkollës	- Nxënësit mund të organizohen për të mbjellë perime dhe lule në kopshtin e shkollës si pjesë e një konkursi.	Mësuesit kujdestarë	18 Shkurt
38.	Dita Botërore e Gjuhës Amtare	- Konkurs i gjuhës shqipe	- Vetëdija për ruajtjen e gjuhës amtare si trashëgimi në breza.	Mësuesit kujdestarë Mësuesit e gjuhës shqipe	21 Shkurt
39.	-Kampionati Kombëtar i Shahut	- - Kampionati do të zhvillohet në dy faza ku gjatë shkurtit do zhvillohet faza e dytë.	-	Nxënësit	Shkurt

40.	Dita ndërkombëtare e matematikës- UNESCO	- Olimpiadë matematike	- Matematika-boshti i botës - Rëndësia e lëndës së matematikës në shumë fusha të jetës.	Mësuesit e matematikës	14 Mars
41.	Dita boterore e ndergjegjesimit per sindromen Down.	- Ftoni nxënësit të veshin çorape të ndryshme si simbol i diversitetit dhe mbështetjes për individët me Sindromën Down. - Ftoni nxënësit të krijojnë vizatime, piktura, ose postera që promovojnë mesazhe mbi përfshirjen, diversitetin dhe të drejtat e individëve me Sindromën Down. - Çdo nxënës shkruan një mesazh për individët me Sindromën Down, duke i inkurajuar dhe mbështetur.	- Të rritet ndërgjegjësimi dhe mirëkuptimi për Sindromën Down. - Të zhvillohet empatia dhe përfshirja mes nxënësve. - Të luftohen paragjykimet dhe stereotipet në komunitetin shkollor.	Qendrat Shëndetësore	2 Mars
42.	Dita boterore e hemofilise. Banka e gjakut	- Prezantim i thjeshtë për të shpjeguar çfarë është hemofilia, si ndikon në jetën e njerëzve, dhe rëndësinë e dhurimit të gjakut për pacientët me këtë gjendje. - Organizoni një fushatë informuese në shkollë mbi rëndësinë e dhurimit të gjakut për pacientët me hemofili dhe për të gjithë ata në nevojë.	- Të ndërgjegjësohen nxënësit dhe komuniteti mbi hemofilinë dhe rëndësinë e dhurimit të gjakut. - Të zhvillohen ndjenjat e solidaritetit dhe empatisë ndaj personave në nevojë.	Qendrat Shëndetësore Shkolla	17 Mars
43.	Dita botërore e poezisë	- Organizoni një recital ku nxënësit lexojnë ose recitojnë poezi të autorëve shqiptarë dhe ndërkombëtarë.	- Poezia më e bukur (dalë pas konkursit në secilën klasë)	Mësuesit e gjuhës shqipe	21 Mars

		- Ftoni nxënësit të krijojnë poezi origjinale me tema si pranvera, dashuria, paqja, ose shoqëria.			
44.	Dita Botërore e Ujit	- Mësimi mbi ciklin e ujit dhe kursimin e ujit. - Eksperimente Shkencore për Ciklin e Ujit (eksperiment për avullimin dhe kondensimin, filtrimi i ujit) - Projekte për ndotjen e ujit dhe pasojat.	- Të mësojnë mbi ujit si një burim jetësor dhe të ndërgjegjësohen për veprimet e tyre për mbrojtjen dhe kursimin e tij	Mësuesit e qytetaris, biologjise, edukimit fizik dhe dituri natyre	22 Mars
45.	-Kampionati Kombëtar i Shahut	- Kampionati do të zhvillohet në dy faza ku gjatë muajve mars-prill do zhvillohet finalja	-	Nxënësit	Mars- Prill
46.	Fushata "Karavani i Shëndetit"	- Organizimi i panaireve të ushqimit, duke avokuar për rëndësinë e ushqyerjes së të shëndetshme, përfshirja në aktivitete fizike dhe sportive, trajtimi i shëndetit mendor dhe bullizmit, si dhe pjesëmarrja në nisma që promovojnë një mjedis të pastër dhe të sigurt.	- Synoin ndarjen e mesazheve të shëndetit në mënyrë sa më atraktive. Pjesëmarrja e fëmijëve, prindërve dhe pjesëtarëve të komunitetit në këto aktivitete masive ndihmon në përmirësimin e ndërveprimit midis tyre lidhur me praktikat e një stili jetese të shëndetshme.	Mësuesit, Nxënësit, Prindërit dhe komuniteti	Mars-Prill
47.	Dita botërore e autizmit	- Organizimi i aktiviteteve në mbështetje të fëmijëve me autizëm, tregim i historive të suksesit ku këta fëmijë integrohen dhe ndihmohen nga të gjithë.	- Të jemi gjithëpërfshirës - Ndërgjegjësimi i nxënësve mbi autizmin dhe pranimin e tjetrit ndryshe.	Drejtoria e shkollës Shërbimi psiko-social Mësuesit ndihmës	2 Prill
48.	Dita Ndërkombëtare kushtuar sportit	- Organizimi i kampionateve në futboll, basketboll, voljeboll për djem e vajza.	- Të ushtrojmë sportin - Rëndësia e aktivitetit fizik në shëndetin fizik dhe mendor të njeriut	Mësuesit e AF	6 Prill

	për zhvillim dhe paqe	- Ndeshje prindër – nxënës		dhe edukimit fizik Koordinatori i shëndetit	
49.	Dita Botërore e Shëndetit	- Promovimi i sjelljeve të shëndetshme përmes prezantimit të **Aplikacioneve për fëmijët**: "Ushqyerja e shëndetshme", "Aktiviteti fizik", "Koronavirusi", "Thuaji Jo Sheqerit", "Fëmijë Special".	- Rritja e njohurive dhe angazhimi i nxënësve në sjelljet e shëndetëshme, me qëllim parandalimin e sëmundjeve jo të transmetueshme në të ardhmen.		7 Prill
50.	Dita botërore e Romëve	- Organizimi i bisedave mbi këmbimin ndërkulturor.	- Të ndryshëm, por të barabartë - Ndërgjegjësimi i nxënësve mbi pranimin e tjetrit ndryshe.	Shërbimi psiko-social dhe mësuesit kujdestarë	8 Prill
51.	Sensibilizimi për rëndësinë e vaksinimit	- Profesionistët e shëndetiti bëjnë një prezantim të thjeshtë për nxënësit për të shpjeguar çfarë janë vaksinat, si funksionojnë, dhe pse janë të rëndësishme për shëndetin. - Ftoni nxënësit të krijojnë postera dhe broshura që theksojnë rëndësinë e vaksinimit. - Prezantoni historinë e vaksinave dhe ndikimin e tyre në eliminimin ose reduktimin e sëmundjeve si lia dhe poliomeliti.	- Të rritet ndërgjegjësimi mbi rëndësinë jetësore të vaksinimit në parandalimin e sëmundjeve. - Të forcohet besimi dhe edukimi në komunitet rreth rolit të vaksinave për një jetë më të sigurt dhe më të shëndetshme.	Qendrat Shëndetësore Shkolla	Prill
52.	Dita botërore e Tokës	- Organizimi i aktiviteteve, për mbjelljen e pemëve në oborrin e shkollës, dhe në ambjente	- Mbrojtja e Tokës, planetit tonë - Ndërgjegjësimi i nxënësve mbi mbajtjen pastër të planetit,	Mësuesit e shkollës	21 Prill

		publike. Mbajtja pastër e ambjenteve si dhe ndarja e plerave sipas katergori si në klasë ashtu dhe jashtë.	rëndësinë e mbjelljes së pemëve, kursimin e burimeve natyrore etj.		
53.	Dita botërore e librit	- Konkursi dhe shpallja e lexuesve më të mirë.	- Jemi miqtë e librit - Rëndësia e leximit për të hapur horizontet e nxënësve.	Drejtoria e shkollës Mësuesit dhe shkrimtarë të ftuar	23 Prill
54.	Java olimpike e sportit	- Organizimi i lojrave olimpike në ambjentet e shkollës, dhe konkurimi midis klasave.	- Lojëra të ndryshme sportive - Organizimi i aktiviteteve të ndryshme për të promovuar rëndësinë e aktivitetit fizik.	Mësuesit e edukimit fizik Koordinatori i shëndetit	8 Maj
55.	Dita Ndërkombëtare e e-twinning	- Nxënësit dhe mësuesit krijojnë ide për një projekt të përbashkët me shkolla partnere ndërkombëtare në kuadër të eTwinning. - Organizoni një panair në shkollë ku prezantohen projekte eTwinning të realizuara nga nxënësit.	- Të promovohen projektet ndërkombëtare të eTwinning dhe përfitimet e tyre. - Të zhvillohen aftësitë bashkëpunuese, krijuese dhe teknologjike të nxënësve dhe mësuesve. - Të inkurajohet shkëmbimi kulturor dhe ndërtimi i marrëdhënieve ndërkombëtare.	Mësuesit e shkollës	7 Maj
56.	Dita e Evropës	- Shfaqja teatrale nga klubi i teatrit.	- Edhe ne pjesë e Evropës. - Promovimi i qenies pjesë të Evropës, jo vetëm fizikisht por në të gjitha aspektet.	Mësuesit e histori-gjeografisë	9 Maj
57.	Dita ndërkombëtare e bashkëjetesës në paqe	- Organizimi i aktiviteteve mbi prindërimi pozitiv. Për të promovuar edukim pa dhunë të fëmijëve.	- Të jetojmë në paqe me njëri-tjetrin. - Promovimi i një jetese në paqe dhe të sigurt.	Mësuesit e shkollës	16 Maj

58.	Dita Botërore për Diversitet Kulturor, Dialog dhe Zhvillim	- Nxënësit përgatisin stenda që paraqesin kultura të ndryshme përmes ushqimeve, veshjeve, muzikës dhe traditave. - Organizoni një lojë ku nxënësit identifikojnë flamuj, ushqime tradicionale, ose fakte interesante mbi vende të ndryshme.	- Të kuptojnë dhe të vlerësojnë diversitetin kulturor, të zhvillojnë një frymë tolerante dhe të mbështesin dialogun si një mënyrë për të jetuar në harmoni.	Mësuesit e shkollës	21 Maj
59.	Përdorimi i teknologjisë për promovimin e sjllejeve të shëndetshme	- Organizimi i një ore mësimore ku prezantohe aplikacionet dhe përmbajtja e tyre: "Jo sheqerit", "Ushqehu shëndetshëm", "Qëndro Aktiv", "Higjena" dhe "Fëmijet special".	- Nëpërmjet aplikacioneve të ndërtuar për fëmijët e moshës 6-16 vjeç, synohet të rritet informimi, ndërgjegjësimi dhe promovomi i sjelljeve të shëndetshme në shkolla.	Mësuesit e shkollës dhe nxënësit	Maj
60.	Dita Botërore pa Duhan.	- Një orë mësimore që shpjegon ndikimin e duhanit në shëndetin e trupit, duke përfshirë sëmundjet e zemrës, kancerin dhe problemet me mushkëritë. - Nxënësit krijojnë dhe ekspozojnë materiale vizuale dhe edukative për shëndetin e mirë pa duhan. - Zhvillimi i një aktivitet fizik si një maratonë ose vrapim i shpejtë, për të promovuar aktivitetin fizik dhe jetesën e shëndetshme pa duhan.	- Të promovohen stilet e jetesës pa duhan dhe të edukohen nxënësit për pasojat shëndetësore të tij. - Të rritet ndërgjegjësimi në shkollë dhe komunitet për rëndësinë e një jete të shëndetshme. - Të inkurajohet mbështetje dhe motivim për ata që duan të ndalojnë duhanin.	Qendrat Shëndetësore	31 Maj
61.	Festa e fëmijëve	- Organizoni një ditë të dedikuar për lojra të ndryshme, duke përfshirë aktivitete të jashtme si gara, kërcim dhe aktivitete grupore.	- Organizojmë aktiviteteve dhe gëzojmë së bashku.	Drejtoria e shkollës dhe mësuesit	1 Qershor

62.	Dita botërore e mjedisit, UNESCO	- Vizita në ferma të ndryshme.	- Edukojmë dhe nxisim mbrojtjen dhe pasurimin e mjedisit. - Promovimi i mbrojtjes së burimeve të paripërtëritshme.	Drejtoria e shkollës dhe mësuesit	5 Qershor
63.	Java e lëvizjes "Now we move"	- Organizimi i konkurseve/garave midi nxënxësve për të nxitur krzerje të aktivitetit fizik.	- Edukojmë nxënësit me sportin. - Promovojmë stilin aktiv te jetës, kundrejt jetës sedentare.	Mësuesit e edukimit fizik dhe AF Koordinatori i shëndetit	10 Qershor
64.	Dita kundër punës dhe shfrytëzimit të fëmijëve	- Edukim bashkëmoshatar i fëmijëve	- Njohim të drejtat dhe përgjegjësitë tona.	Drejtoria dhe mësuesit e shkollës	12 Qershor
65.	Ndërgjegjësimi për luftën kundër drogës.	- Organizoni një orë mësimi ku punonjësi shëndetësor shpjegon efektet shkatërruese të drogës në trupin dhe mendjen e individit. Fëmijët mund të diskutojnë rreth pasojave të drogës dhe rëndësisë së thyerjes së zinxhirëve të varësisë. - Nxënësit krijojnë një shfaqje teatrale që ilustron pasojat e përdorimit të drogave dhe rëndësinë e të qëndruarit larg tyre.	- Të rritet ndërgjegjësimi i nxënësve dhe komunitetit për rrezikun e përdorimit të drogës. - Të inkurajohet nxënësit që të bëjnë zgjedhje të shëndetshme dhe të shmangin përdorimin e substancave narkotike. - Të promovohen alternativat e shëndetshme dhe të krijohet një mjedis mbështetës për të luftuar kundër drogave.	Qendrat Shëndetësore	Qershor
66.	Parandalimi i dhunës dhe abuzimeve seksuale.	- Organizoni sesione me stafin shëndetësor për të diskutuar rreth mënyrave për të menaxhuar stresin, presionin shoqëror dhe situatat që mund të çojnë në dhunë. Nxënësit mund të mësojnë gjithashtu si të mbrojnë kufijtë personalë dhe si të	- Të edukohen nxënësit për pasojat e dhunës dhe abuzimit seksual. - Të zhvillohen aftësi të mbrojtjes personale dhe të kërkimit të ndihmës. - Të krijohet një mjedis mbështetës dhe të sigurt për të gjithë nxënësit, duke i ndihmuar ata të kuptojnë	Qendrat Shëndetësore	Qershor

		kërkojnë mbështetje kur ndihen të pasigurt. - Nxënësit dhe mësuesit mund të punojnë së bashku për të krijuar një listë rregullash për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve në shkollë. Kjo mund të përfshijë diskutime mbi sjelljet që janë të papranueshme dhe pasojat e këtyre sjelljeve.	rëndësinë e respektit dhe kujdesit për njëri-tjetrin. - Të ndërgjegjësohen prindërit dhe komuniteti për parandalimin dhe pasojat e dhunës dhe abuzimeve seksuale.		
67.	Edukimi mbi sigurinë gjatë pushimeve verore: Këshilla për shëndetin dhe sjelljet që duhet të kemi gjatë sitnës së verës.	- Organizoni një orë mësimi ku nxënësit mund të mësojnë për rreziqet e mundshme gjatë verës dhe si mund të ruajnë sigurinë dhe shëndetin e tyre. Aktiviteti mund të përfshijë diskutime mbi rrezikun e djegieve nga dielli, dehidratimin, sigurinë në ujë, dhe mbrojtjen nga insektet. - Nxënësit mund të diskutojnë mbi rëndësinë e higjienës dhe ushqimit të shëndetshëm gjatë verës. Ky aktivitet mund të përfshijë diskutime mbi ruajtjen e ushqimit në kushte të sigurt dhe shmangien e ushqimeve të prishura gjatë nxehtësisë, si dhe rëndësinë e ushqimeve të freskëta për të mbajtur trupin të hidratuar dhe të shëndetshëm.	- Të informohen nxënësit mbi masat që mund të merren për të mbajtur sigurinë dhe shëndetin gjatë pushimeve verore. - Të krijohet një ndërgjegjësim për rreziqet e mundshme dhe mënyrat për të parandaluar ato, si djegiet nga dielli, siguria në ujë, dhe kujdesi për ushqimin dhe higjienën. - Të zhvillohen aftësitë për t'u kujdesur për veten dhe të tjerët gjatë verës, duke ndihmuar nxënësit të ruajnë shëndetin dhe sigurinë gjatë pushimeve.	Shkollat Qendrat Shëndetësore	Qershor
68.	Ambasadori i shëndetit në shkollë	Nxënësit mund të krijojnë: - Vizatime ose piktura që ilustrojnë mënyra të	"Ambasadori i Shëndetit" është një iniciativë fantastike për të inkurajuar nxënësit të shprehin kreativitetin e tyre	Mësuesit e shkollës	Gusht

		shëndetshme jetese, si ushqimi i shëndetshëm, aktivitetet fizike, dhe kujdesi për shëndetin mendor. - Video që ilustrojnë praktika të shëndetshme si ushqimi i shëndetshëm, aktiviteti fizik, dhe menaxhimi i stresit. - Dokumentarë të shkurtër që shpjegojnë rëndësinë e shëndetit në jetën e përditshme. - Postera me mesazhe pozitive për shëndetin dhe t'i ekspozojnë në shkollë	dhe të promovojnë një mënyrë jetese të shëndetshme nëpërmjet artit, muzikës dhe videove. Ky aktivitet mund të krijojë një mundësi për nxënësit që të lidhen me tema shëndetësore në një mënyrë më interesante dhe të angazhohen për të promovuar mesazhe pozitive dhe edukative.		
69.	Dita Ndërkombëtare e Rinisë UNESCO.	-	-		12 Gusht
70.	Dita Europiane e Kujtesës për të gjitha viktimat e regjimeve totalitare.	-	-		23 Gusht